



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORTI PËR VEPRIMTARINË VJETORE 2021

21 MARS 2022

Raporti në format elektronik



KQZ

Available on the
App Store

Get it on
Google play



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



www.kqz.gov.al

TABELA PËRMBLEDHËSE

Hyrje	4
KREU I: PERIUDHA PARA ZGJEDHORE	5
Seksioni I: Planifikimi dhe Implementimi	5
1. Kuadri ligjor dhe rregullator	5
2. Administrimi i denoncimeve.....	12
3. Manaxhimi i burimeve njerëzore të KQZ-së	15
Seksioni II: Planifikimi buxhetor dhe prokurimi	20
1. Financimi	20
2. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve	26
Seksioni III: Teknologjia në zgjedhje	28
1. Identifikimi Elektronik.....	28
2. Pajisjet Elektronike të Votimit dhe Numërimit.....	30
3. Aksesit i publikut në KQZ, transparenca	31
4. Sistemet e informacionit zgjedhor	36
5. Kamerat në zgjedhje dhe transmetimi video në kohë reale.....	36
Seksioni IV: Lista e zgjedhësve, Caktimi i Mandateve, Zonat e Administrimit Zgjedhor	37
1. Lista e zgjedhësve	37
2. Ndarja e ZAZ-ve	37
3. Përcaktimi i mandateve për çdo qark	38
Seksioni V: Trajnimi i administratës zgjedhore dhe grupeve të interesit	38
1. Organizimi i trajnimit të administratës zgjedhore.....	38
2. Zhvillimi i trajnimit.....	39
3. Trajnimet në kuadër të financimit të fushatës zgjedhore	40
Seksioni VI: Emërimi i administratës zgjedhore	41
1. Emërimi i komisionerëve dhe konstituimi i KZAZ-ve	41
2. Emërimi i anëtareve të KQV-ve dhe GNV	43
Seksioni VII: Edukimi i Zgjedhësve dhe Vëzhguesit	45
1. Edukimi i zgjedhësve	45
2. Vëzhguesit e huaj dhe marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë	48
Seksioni VIII: Objektet zgjedhore dhe ambjentet e punës të administratës zgjedhore	53
1. Selitë e KZAZ-ve	53
2. Qendrat e Votimit	53

3. Infrastruktura dhe energjia për QV dhe VNV	54
4. Vendet e Numërimit të Votave	54
5. Administrimi operacional i dokumentacionit të KZAZ-ve	54
Seksioni IX: Infrastruktura dhe materialet zgjedhore	55
1. Përgatitja e materialeve zgjedhore/ mjeteve logjistike dhe infrastrukurore për zhvillimin e zgjedhjeve.	55
2. Mjetet dhe materialet për KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të	56
Seksioni X: Regjistrimi i subjekteve, fushata zgjedhore dhe integriteti zgjedhor	57
1. Regjistrimi i subjekteve	57
2. Financimi i fushatës dhe integriteti zgjedhor	57
3. Afishimi i materialeve propagandistike.	58
4. Ndjekja e ankimeve ndaj akteve të Komisionerit në KAS	59
5. Raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore	66
6. Kontrolli i financimit të fushatës zgjedhore	67
7. Shpërndarja e fondeve paradhënie nga buxheti i shtetit për zgjedhjet e datës 25 prill 2021	67
Seksioni XI: Media gjatë fushatës zgjedhore	68
1. Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore	68
2. Raportet e monitorimit të medias audio dhe vizive	69
Kreu II: Dita e Zgjedhjeve dhe rezultati	70
1. Hapja e QV	70
2. Procedurat e numërimit dhe shpalljes së rezultatit	72
3. Marrja në dorëzim e kutive të numëruara dhe materialeve zgjedhore.	74
4. Rezultati i zgjedhjeve	74
Kreu III: Periudha paszgjedhore	74
Seksioni 1. Analiza e realizimit buxhetor	74
Seksioni II: Administrimi dhe arkivimi i dokumentacionit	79
Seksioni III: Përcaktimi i vlerës në para' të një vote & Kompensimi financiar paszgjedhor	80
Seksioni IV: Analiza paszgjedhore dhe efektshmëria e teknologjisë së zbatuar	82
Seksioni IV: Këqyrja Paszgjedhore	83
Seksioni V: Masat administrative dhe disiplinore pas verifikimit paszgjedhor	89
Seksioni VI: Raporti i auditimit të kryer për raportimin financiar për fushatën zgjedhore	89
Seksioni VII: Procese të tjera	90
Seksioni VIII: Raporti i auditimit të kryer për raportimin financiar për vitin kalendarik	97

Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hyri në vitin 2021 me një trupë të sapo-konstituar, duke trashëguar sfida të shumta nga kërkesat e shtuara të Kodit Zgjedhor paralelisht me detyrën për organizimin, administrimin e procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, zgjedhësit patën mundësi të zgjidhnin mes kandidatëve, të cilët mundën të bënin fushatë në mënyrë të lirë dhe në kushtet e një kuadri ligjor që respekton liritë themelore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), tashmë i reformuar, iu përkushtua mbikqyrjes së procesit zgjedhor në mënyrë të organizuar dhe transparente, pavarësisht detyrimeve të reja të konsiderueshme, duke përfshirë edhe zbatimin e teknologjive të reja.

KQZ për shkak të sfidave të shumta dhe kohës shumë të ngushtë për të implementuar kërkesat e reja ligjore synoi pikërisht transparencën më të lartë, si për veprimet e tij administrative/operacionale ashtu edhe për mundësimin dhe realizimin me sukses të mjeteve transparente të imponuara nga ndryshimet e reja ligjore.

Zgjedhjet parlamentare u mbajtën pas një marrëveshjeje të re politike të arritur në qershor të vitit 2020, e cila u pasua nga reforma zgjedhore.

Për herë të parë, në një kohë tepër të shkurtër pas amendimeve të Kodit Zgjedhor të vitit 2020, u implementua identifikimi elektronik i votuesve dhe nënshkrimi elektronik në ditën e zgjedhjeve nëpërmjet pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve dhe nënshkrimin elektronik, si dhe videomonitorimi i qendrave të votimit, që synon monitorimin e veprimtarisë së administratës zgjedhore në qendrat e votimit.

Mekanizmi i ri i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik të votuesve prezanton një garanci të shtuar, krahasimisht me përvojën e deritanishme të procesit zgjedhor në Shqipëri, për rritjen e transparencës së procesit zgjedhor, integritetit dhe eficiencës së tij.

Në përputhje me praktikën e mira zgjedhore, KQZ-ja pilotoi teknologjinë e re të votimi dhe numërimi elektronik në 32 qendra votimi në Tiranë nga 5,199 qendra votimi në të gjithë vendin.

Viti 2021 ishte një vit i mbushur plotë sfida dhe detyra të realizuara me sukses nga KQZ dhe administrata zgjedhore duke përmbushur edhe detyrat e ngarkuara nga Kuvendi i Shqipërisë me Rezolutën nr. e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020”.

Me vendimin nr. 22, datë 23.2.2022, Komisioni Rregullator miratoi Kodin e Etikës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.¹

¹ Rekomandimi 1 i Rezolutës së Kuvendit

KREU I: PERIUDHA PARA ZGJEDHORE²

Seksioni I: Planifikimi dhe Implementimi

1. Kuadri ligjor dhe rregullator

Në përmbyllje të reformës zgjedhore të vitit 2020, Kodi Zgjedhor pësoi dy amendime thelbësore, në lidhje me rikonceptimin strukturor të organeve e drejtuese të KQZ me kompetenca të ndara, si dhe parashikime të reja ligjore për partitë politike, subjektet zgjedhore garuese, zgjedhësit dhe institucionet publike.

Reforma e fundit zgjedhore krijoi një arkitekturë të re të mënyrës së funksionimit dhe organizimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke krijuar tre organe drejtuese.

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) si organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.
- Komisioni Rregullator si organ kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.
- Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve si organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të Ligjit Zgjedhor.

Ndryshimet e fundit të kodit zgjedhor, ndër të tjera, kishin për qëllim rritjen e transparencës në proceset zgjedhore në tre fusha: - financimi i fushatës; - futja e teknologjisë në procese të caktuara zgjedhore; - keqpërdorimi i burimeve publike.

Këto parashikime diktuan hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e tyre, përcaktimin e mekanizmave dhe ristrukturimin e vetë organikës administrative të KQZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u përball me detyrime që lidheshin me:

- identifikimin e projektakteve për t'u hartuar,
- priorizimin e akteve për t'u hartuar në funksion të procesit parazgjedhor e zgjedhor,

Në kuadër të ndryshimeve që pësoi ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, hartoi akte sipas parashikimeve të reja ligjore për partitë politike, subjektet zgjedhore dhe zgjedhësit.

Procesi i hartimit të kuadrit nënligjor sipas parashikimeve të reja të Kodit Zgjedhor, startoi në fund të vitit 2020 dhe fillim të vitit 2021, me përcaktimin e bazës ligjore, sipas autorizimit ligjor të tij.

² Ky kre dhe krerët në vijim përmbushin kërkesën nr. 2 të Rezolutës së Kuvendit të datës 24.6.2021

Përgjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit 2021, në funksion të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, u hartuan aktet nënligjore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sikurse dhe të Komisionit Rregullator, të cilat rregulluan sipas objektit të tyre, çështjet e organizmit dhe funksionimit të procesit zgjedhor që lidheshin me komisionet zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV), detyrat, proceset e punës, dokumentacionin e përgjegjësitë e komisionereve. Gjithashtu, u përcaktuan zonat e administrimit zgjedhor, rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitja e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në lidhje me teknologjinë në zgjedhje, u hartuan aktet e Komisionit Rregullator për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve; u përcaktuan rregullat procedurale për procesin e Votimit dhe Numërimit Elektronik nëpërmjet Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN) të qendrave të votimit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.40, në qarkun Tiranë; rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në Vendet e Numërimit të Votave; përdorimi i kamerave në qendrat e votimit.

Në fokus të veçantë ishin aktet për financimin e fushatës zgjedhore, përdorimi i materialeve propagandistike, roli i financierëve të partive politike, monitorimi i fushatës, keqpërdorimi i aseteve publike në shërbim të fushatës, përfshirë përdorimin e administratës.

U miratuan aktet nënligjore për akreditimin e vëzhguesve si dhe u akredituan ata.

Në funksion të transparencës, procesi i hartimit të projektakteve nënligjore iu nënshtrua konsultimit të tyre me grupet e interesit përfshirë partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile. Sugjerimet dhe propozimet e tyre iu nënshtruan procesit të vlerësimit nga ana e stafit të KQZ-së, duke ripunuar projektaktet dhe relacionet shpjeguese.

Procesi i miratimit të akteve nënligjore u zhvillua në seanca publike të transmetuara në kohë reale dhe me pjesëmarrjen e grupeve të interesit të cilët patën mundësi të shprehin opinionet e tyre edhe gjatë shqyrtimit.

Pas miratimit, projektaktet u zbardhën dhe u publikuan në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së, brenda 24 orëve nga miratimi i tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si dhe Komisioni Rregullator në KQZ përgjatë vitit raportues 2021, kanë miratuar 515 (pesëqind e pesëmbëdhjetë), akte nënligjore nga të cilat 500 (pesëqind) janë vendime dhe 15 (pesëmbëdhjetë) udhëzime.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar 494 (katërqind e nëntëdhjetë e katër) akte nënligjore, nga të cilat 479 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) janë vendime si dhe 15 (pesëmbëdhjetë) udhëzime ndërsa Komisioni Rregullator ka miratuar 21 (njëzetë e një) vendime në përmbushje të detyrimeve ligjore për organizimin dhe drejtimin e zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021.

- **6 (gjashtë) mujori i parë i vitit 2021**, u diktua nga një dinamizëm i lartë i procesit administrativ si dhe në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me strukturën organizative të kohës ka miratuar 441 (katërqind e njëzetë e një) vendime si dhe 14 (katërmëdhjetë) udhëzime.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar 421 (katërqind e njëzetë e një) vendime dhe 14 (katërmëdhjetë) udhëzime, përgjatë kësaj periudhe, të cilat janë të grupuara si vijon:

- 39 (tridhjetë e nëntë) vendime për vakancat e krijuara në këshillat bashkiak.
- 58 (pesëdhjetë e tetë) vendime për organizimin e punës në Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor.
- 104 (njëqind e katër) vendime për shqyrtimin administrativ të denoncimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
- 1 (një) vendim për edukimin e zgjedhësve.
- 2 (dy) vendime për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për vitin 2021.
- 2 (dy) vendime për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë për propozimin e projektligjeve.
- 1 (një) vendim për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021.

- 49 (dyzetë e nëntë) vendime për shqyrtimin e kërkesave së subjekteve zgjedhore për t'u regjistruar si subjekte zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 8 (tetë) vendime për shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e Komitetiteteve Nismëtare që do të organizojë punën për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 58 (pesëdhjetë e tetë) vendime për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 6 (gjashtë) vendim për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme.
- 1 (një) vendim shqyrtim e kërkesës ankimore të depozituar në Komisionin e Ankimeve dhe Sankioneve.
- 1 (një) vendim për shqyrtimin e kërkesës së z. Xhavit Zhuzhi për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Emigracioni Shqiptar në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021
- 5 (pesë) vendim për financimin, monitorimin dhe auditimin e fushatës zgjedhore.
- 3 (tre) vendime për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicioneve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 5 (pesë) vendime për shqyrtimin e kërkesës për e kandidatëve për deputet të propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- 13 (trembëdhjetë) vendime për kthimin për korrigjim të dokumenteve të listës shumë-mërore të kandidatëve për deputet të depozituara nga subjektet zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- 14 (katëmbëdhjetë) vendime për miratimin e listave shumë-mërore të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- 3 (tre) vendime për hedhjen e shortit mbi fletën e votimit.
- 1 (një) vendim për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.
- 3 (tre) vendime për shqyrtimin e raportit të Autoriteti të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore.

- 17 (shtatëmbëdhjetë) vendime për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga Anëtarët dhe Sekretarët e KZAZ-ve.
- 12 (dymbëdhjetë) vendime për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.
- 2 (dy) vendime për dhënien e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore.
- 1 (një) vendim për shpalljen e mozgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumëmemërore
- 12 (dymbëdhjetë) vendime për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonat zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021.
- 14 (katërmëdhjetë) udhëzime të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si më poshtë vijon:
 - 3 (tre) udhëzime në kuadër të financimit dhe auditimit të partive politike.
 - 1 (një) udhëzim për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjekteve zgjedhore.
 - 1 (një) udhëzim për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga Buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
 - 1 (një) udhëzim për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin e publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.
 - 1 (një) udhëzim për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave.
 - 1 (një) udhëzim për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore.
 - 1 (një) udhëzim për miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerës për video rregjistrim në mjedisin e brendshëm të Qendrës së Votimi.
 - 2 (dy) udhëzime në zbatim të masave anti-Covid.

- 1 (një) udhëzim për përdorimin e aplikacionit KQZ.
- 1 (një) udhëzim për administrimin e listës së zgjedhësve përgjatë procesit të votimit në qendrën e votimit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- 1 (një) udhëzim për mënyrën e pasqyimit të raporteve të mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve nga Pajisja e Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve (PEI) në Qendrën e Votimit, në të cilën printimi është i palexueshëm.

Komisioni Rregullator, ka miratuar 20 vendime. Vendimmarrje e Komisionit Rregullator përgjatë kësaj periudhe është e grupuar si më poshtë vijon:

- 9 (nëntë) vendime rregulluan sipas objektit të tyre ceshtjet e organizmit dhe funksionimit të procesit zgjedhor e lidheshin me komisionet zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV), detyrat, proceset e punës, dokumentacionin e përgjegjësitë e komisionereve në qendrat e votimit.
- 4 (katër) vendime që lidheshin me procedurat e administrimit të pajisjeve të teknologjisë së informacioni (PEI, kamerave në qv, pajisjeve PEVN), proces i cili përfshiu analizimin, hartimin dhe harmonizimin e tyre.
- 3 (tre) vendime për financimin e fushatës zgjedhore, përdorimi i materialeve propagandistike, roli i financierëve të partive politike, monitorimi i fushatës, keqpërdorimi i aseteve publike në shërbim të fushatës, përfshirë përdorimin e administrates
- 2 (dy) vendime për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 si dhe përcaktimi i procedurës për hedhjen e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
- 1 (një) vendim për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, për shkak se dispozitat e Kodit Zgjedhor parashikonin organ kompetent për këtë procedurë Komisionerin Stetëror të Zgjedhjeve.
- 1 (një) vendim parashikoi procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre.

Aktet nënligjore që janë në kompetencë të Komisionit Rregullator, propozohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ndaj akteve të miratuara nga Komisioni Rregullator nuk u paraqit asnjë ankim në Kolegjin Zgjedhor.

- **Në 6 (gjashtë) mujorin e dytë të vitit 2021**, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me strukturën organizative të kohës ka miratuar 59 (pesëdhjetë e nëntë) vendime si dhe 1 (një) udhëzim.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar përgjatë kësaj periudhe 58 (pesëdhjetë e tetë) vendime dhe dhe 1 (një) udhëzim. Këto 58 (pesëdhjetë e tetë) vendime janë grupuar si më poshtë vijon:

- 27 (njëzetë e shtatë) vendime janë miratuar në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Nga këto 28 (njëzetë e tetë) vendime janë miratuar, për plotësimin e vakancave në këshillat bashkiak dhe 6 (gjashtë) vendime për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektet vetëdeklarues.
- 9 (nëntë) vendime janë miratuar në kuadër të hetimeve administrative të ardhura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të raportuara gjatë periudhës para dhe pas zgjedhore.
- 7 (shtatë) vendime në kuadër të të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- 6 (gjashtë) vendime janë miratuar për auditimin dhe kontrollin financiar të partive politike.
- 4 (katër) vendime për dhënien e mandatit kandidatit të rradhës për deputet në Kuvendin e Shqipërisë si rezultat i vakance të krijuara
- 3 (tre) vendime në kuadër të zbatimit të nenit 167/2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- 1 (një) vendim për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvend e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021.
- 1 (një) vendim për kompensimin financiar paszgjedhor që do të shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021
- 1 (një) udhëzim Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore.
- 1 (një) vendim për miratimin e raportit të verifikimit paszgjedhor.

Komisioni Rregullator, ka miratuar 1 (një) vendim i cili konsistonte në shpalljen e rezultetit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, i cili shënjoi dhe fundin e këtij procesi dinamik për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Administrimi i denoncimeve

Në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të vendimit nr. 9, datë 9 Mars 2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” si dhe ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë raportuar nga porta në ndryshme hyrëse **136 denoncime**, për të cilat 133 raste janë trajtuar me vendimmarrje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe janë marrë 113 vendime për shkak se disa denoncime janë trajtuar në të njëjtin vendim pasi kanë pasur të njëjtin objekt denoncimi por subjekte të ndryshme denoncues ndërsa 3 raste janë trajtuar me korrespondencë shkresore.

Denoncimet e raportuara janë të grupuara si më poshtë vijon:

- 68 denoncime janë përcjellë nga subjektet të ndryshme politike, përkatësisht 36 denoncime nga subjekti politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, 32 denoncime nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë.
- 29 denoncime janë përcjellë nga institucione publike
- 15 denoncime janë përcjellë nga sinjalizues.
- 22 denoncime janë përcjellë nga Organizata Ndërkombëtare, përkatësisht 6 denoncime nga Qendresa Qytetare, 4 denoncime nga Instituti i Studimeve Politike 11 denoncime nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe 1 denoncim nga Instituti Shqiptar i Shkencave
- 2 denoncime janë përcjellë nga bashki të ndryshme, përkatësisht bashkia Rroskovec, dhe Bashkia Tropojë.

Denoncimet e raportuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë pasur për objekt:

- 42 (dyzetë e dy) denoncime kanë pasur për objekt, shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) denoncime kanë pasur për objekt, shkelje të vendimit nr. vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”
- 18 (tetëmbëdhjetë) denoncime kanë pasur për objekt, shkelje të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në kuadër të denoncimeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mbi rastet e denoncimeve të përcjella në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka marrë 113 vendime për 136 raste denoncimesh, për shkak se disa nga këto denoncime janë bashkuar së bashku sepse kanë pasur të njëjtin objekt denoncimi por subjekte të ndryshme denoncuesish.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pas hetimit të plotë dhe të gjithëanshëm nëpërmjet vendimmarrjessë tij ka vendosur:

- Për 68 raste denoncimesh ka vendosur përfundimin e shqyrtimit administrativ për shkak se nuk ka shkelje në dispozitat ligjore referuese.
- Për 21 raste denoncimesh ka vendosur mosfillimin e hetimit administrativ për shkak se nuk ka prova dhe fakte të mjaftueshme për të vijuar hetimin administrativ.
- Për 7 raste denoncimesh ka vendosur marrje të menjëhershme të masave për heqjen e materialeve propagandistike në objektet që sjanë të përcaktuara në vendimin e kryetarit të bashkisë “Për përcaktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike”.
- Për 4 raste denoncimesh ka vendosur sanksion administrativ me gjobë për shkak të shkeljeve të konstatuara pas hetimit administrativ.
- Për 2 raste denoncimesh ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore të tij për shqyrtimin e kërkesës dhe të përcjellë menjëherë kërkesën për kompetencë.
- Për 11 raste denoncimesh ka vendosur të shpallë moskompetencë lëndore për vijimin e hetimit administrativ.

Në Komisionin e Ankimimeve dhe Sankisoneve, janë ankimuar 8 (tetë) vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përkatësisht vendimet:

- Nr. 7, datë datë 14.01.2021, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ndaj z. Arben Qalliu”.
- Nr. 46, datë 09.02.2021, “Për shqyrtimin administrative të denoncimeve për shkeje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”.
- Nr. 140, datë 15.03.2021, “Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Vorë”.
- Nr. 235, datë 14.04.2021, “Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ dhe

udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Librazhd”.

- Nr. 423, datë 05.07.2021, “Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidates për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore Kukës, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.
- Nr. 424, datë 12.07.2021, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ndaj Bashkisë Tiranë”
- Nr. 427, datë 16.07.2021, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ndaj Bashkisë Tiranë”.
- Nr. 457, datë 01.10.2021, “Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi rastet e ankimuara, me vendimmarje të tij vendosi për:

- 3 (tre) raste ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
- 1 (një) rast lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 3 (tre) raste shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe riçeljen e hetimit administrativ për të njëjtën çështje.
- 1 (një) rast mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore.

3. Manaxhimi i burimeve njerëzore të KQZ-së

- **Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil:**

Në fillim të vitit kalendarik dbnj përcakton në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil numrin e vendeve vakante. Bazuar në nevojat e institucionit, plani vjetor për vitin 2021, pjesë e shërbimit civil, përfshiu 15 pozicione të lira të ndara sipas kategorive. Respektimi i numrit të planifikuar për vende vakante nuk u respektua për shkak të zhvillimeve të ndodhura dhe të nevojave për burime njerëzore që lindën përgjatë vitit.

- **Zhvillimi i procedurave të rekrutimit**


Në zbatim të ligjit për nëpunësin civil janë kryer 27 procedura rekrutimi;

2 (dy) Trupa e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues

2 (dy) Kategori e mesme drejtuese

9 (nëntë) Kategori e ulët drejtuese

14 (katërmbëdhjetë) Kategori ekzekutive



Plotësimi i vendeve vakante në institucion është kryer nëpërmjet procedurave si më poshtë:

3 (tre) kandidatë jashtë shërbimit civil 20%

1 (një) kategori e mesme drejtuese,

2 (dy) kategori e ulët drejtuese

5 (pesë) Lëvizje paralele

3 (tre) kategori e ulët drejtuese

2 (dy) kategori ekzekutive

1 (një) Ngritje në detyrë kategori e mesme drejtuese,

6 (gjashtë) Pranim në shërbimin civil

• Regjistri informatik i menaxhimit të burimeve njerëzore HRMIS

Plotësimi dhe përditësimi i sistemit informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore me të dhënat e punonjësve të Institucionit sipas dokumentacionit që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me qëllim krijimin e një bazë unike të dhënash shtetërore (RQP) ku ruhet e përpunohet elektronikisht informacioni për institucionin.

- Caktimi i monitoruesve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për veprimtarinë e partive politike/kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore caktoi 64 monitorues të cilët monitoruan veprimtaritë e partive politike/kandidatëve në kohë reale.

Në muajin Shkurt 2021, KQZ-ja shpalli thirrjen publike për shprehje interesi për tu punësuar si monitorues për fushatën zgjedhore. Pas aplikimeve u bë përzgjedhja e tyre dhe shpërndarja e monitoruesve u bë në bazë të shortit të hedhur për secilin qark.

KQZ-ja trajnoi 64 monitoruesit në platformë online për arsye të pandemisë covid 19.

- Rekrutimi i trajnerëve

Për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për realizimin e kurseve dhe sesioneve të trajnimit për të gjithë administratën zgjedhore, KQZ-ja angazhoi për te treja fazat e trajnimit te komisionereve 242 trajnerë nga të gjithë qarqet, të cilët u përzgjedhën mbi bazën e një konkurrimi të hapur dhe transparent.

Në fazën e parë të trajnimeve për anëtarë e KZAZ-ve, KQZ emëroi 59 trajnerë (33 gra dhe 26 burra).

Në fazën e dytë të trajnimeve për anëtarët e KQV-ve u emëruan 264 trajnerë si dhe 56 trajnerë të cilët u angazhuan për trajnimin e operatorëve të pajisjes së identifikimit elektronik (PEI). Ky proces u shoqërua me fenomenin e dorëheqjeve, 30 prej tyre dhanë dorëheqje.

Në këtë fazë të dytë u aktivizuan për trajnimin e anëtarëve të KQV-ve 234 trajnerë, nga të cilët 138 ishin gra dhe 96 burra.

Fenomeni i shfaqur këtë vit në këtë magnitudë shpjegohet së pari për shkak të situatës të vështirë të kufizimeve të covidit, se dhe momenti kur u azhurnuan me skemën vetjake të trajnimit që në shumicën e rasteve vendet e trajnimit ishin larg vendbanimit të tyre.

Në fazën e tretë të trajnimeve për anëtarët e GNV-të u emëruan 92 trajnerë (43 gra dhe 49 burra).

Trajnimet e ToT të të gjitha niveleve u ofruan on-line ne platformën zoom, nga administrata e KQZ, për shkak te pandemisë COVID-19.

- **Zhvillimi i burimeve njerëzore**

Zhvillimi i karrierës

- Të dhënat e mëposhtme synojnë të tregojnë mundësinë që u jepet nëpunësve civil për të zhvilluar karrierën e tyre, duke u bazuar në kritere objektive, transparente dhe meritokratike brenda institucionit.
- 3 (tre) nga 6 (gjashtë), 50% vende të shpallura me procedurën lëvizje paralele janë plotësuar brenda institucionit;
- 2 (dy) nga 8 (tetë), 20% vende të shpallura janë plotësuar me procedurën ngritje në detyrë janë plotësuar brenda institucionit.



Figura 1: Të dhëna në numër dhe përqindje të zhvillimit të karrierës në institucion

Vlerësimi i performancës dhe motivimi

- Për rritjen e motivimit të administratës ka shërbyer edhe vlerësimi objektiv i rezultateve në punë të nëpunësve civil. Të administruar nga DBNJ për vitin 2021 janë gjithsej 56 formularë vlerësimi.
- 3 punonjës janë vlerësuar për periudhën e provës,
- 25 punonjës, janë vlerësuar “shumë mire”;
- 28 punonjës, janë vlerësuar “mirë”;

Stabiliteti

- 4 (katër), 2 % pozicione pune pezullimin nga shërbimi civil;
- 3 (tre), 2 % pozicione pune dorëheqje nga shërbimi civil dhe 1 (një) Kod Pune;
- 1 (një), 1 % pozicion pune për arsye të plotësimit të moshës së pensionit.

Legjislacioni

- Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për marrëdhëniet e punës,
- 1 (një) pozicion pune në favor të nëpunësit.

Zhvillimi i performancës /trajtime

- Një ndër objektivat kryesore të institucionit vijon të mbetet rritja e kapaciteteve të nëpunësve të administratës nëpërmjet ASPA-s, hartimit të një programi 1-3 vjeçar gjithëpërfshirës për të gjitha kategoritë, përfshirë këtu edhe personelin e rekrutuar me kohë jo të plotë pune gjatë periudhës zgjedhore.
- Të dhëna në përqindje në lidhje me trajnimet.
- 80 % e nr të punonjësve, kanë plotësuar planin e trajnimit të ASPA me tema trajnimi;
- 30% e nr të punonjësve, kanë marrë pjesë në trajnim;
- 11 punonjësve, u është krijuar mundësia për ndjekjen e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s.

- 60% e nr të punonjësve më kohë jo të plotë pune.

Rekrutimi dhe menaxhimi i personelit me kohë jo të plotë pune


Me qëllim për të mbështetur stafin e përhershëm në përmbushjen e detyrave të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, për herë të parë u dërgua për miratim Kuvendit strukturën e administratës së KQZ-së me kohë jo të plotë pune. Relacioni u përgatit mbi bazën e të gjithë propozimeve të Drejtorive të Administratës së KQZ-së.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 u punësuan gjithsej 347 punonjës, me kohë jo të plotë pune. Punonjësit luajtën rol mbështetës për zbatimin e të gjitha hallkave që nevojiten për kryerjen e detyrave konkrete për çdo pozicion pune e mbështetur kjo sipas kërkesave të çdo drejtorie. Në zbatim të vendimit 69/2020 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për periudhëm zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” njesia përgjegjëse shpalli vendet vakante të ndarë në këto kategori:

- a. Specialist Jurist, specialist të IT, të Financës, të Trajnimit, të Edukimit të Zgjedhësve, të Burimeve Njerëzore, të Shërbimeve të Logjistikës, etj;
- b. Operatorë;
- c. Teknik të specialiteteve të ndryshme dhe;
- d. Punonjës të Shërbimit dhe mirëmbajtjes si fotokopjues, punonjës ngarkim/shkarkimi, sanitar etj.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për plotësimin e vendeve vakante njesia përgjegjëse kreu:

1. Njoftimin publik për vende të lira pune dhe mënyrën e dorëzimit e dokumentacionit:
 - Online, në faqen zyrtare elektronike të KQZ-së për herë të parë diktuar nga kushtet e zhvillimit teknologjik;
 - pranë zyrës së protokollit të KQZ-së;
 - me anë të postës.



Grafik: Të dhëna në numër në lidhje me kërkesat e dorëzuara.


2. Përzgjedhjen e kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara.
3. Njoftimin dhe intervistën e strukturuar me gojë.
4. Hartimin dhe lidhja e kontratës.

Punësimi i ekselentëve

Për herë të parë, më synimim për të nxitur për përfshirjen e studentëve ekselentë në administratën e përkohshme zgjedhore, njësia përgjegjëse shpalli njoftimin e punësimit të tyre pa procedurë rekrutimi.

Numri total i studentëve që aplikuan ishte 3 (tre) të cilët u sistemuan sipas profileve përkatëse.

Diktuar nga kushtet e pandemisë kontratat individuale për 59 trajnues KZAZ-ve, 236 trajnues KQV-ve, 75 trajnues GVV-ve, dhe 56 trajnues PEI, u kryen nëpërmjet e-mail-it.



Seksioni II: Planifikimi buxhetor dhe prokurimi

1. Financimi

Me ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” datë 16.11.2020, për realizimin e Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, për programin buxhetor, kodi 01620, “Zgjedhje të përgjithshme dhe lokale”, u akordua fondi 1 miliardë Lekë.

KQZ me Vendimin Nr.29, Datë 14.12.2020 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore per zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021”, miratoi shumën prej 1 miliard e 309 milionë Lekë si fonde të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, nga 1 miliard Lekë të miratuara në ligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.

Me Vendimin Nr.73, Datë 05.02.2021 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021”, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021” Ministria e Financave alokoi fondin total prej 1 miliard e 309 milionë Lekë.

Për shkak të ndryshime të Ligjit Nr.10019 Datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili prekte edhe anën organizative të procesit zgjedhor, lindi nevoja të shtoheshin në zërat e buxhetit produkte të cilat nuk ishin të parashikuar më parë.

KQZ me Vendimin Nr.112, Datë 03.03.2021 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr.29, Datë 14.12.2020 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, me vendimin nr.135, datë 05.03.2021 Këshilli i Ministrave, vendosi ndryshimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill, në shumën prej 1 miliard e 457 milionë Lekë.

Me Aktin Normativ Nr.4, Dt.05.05.02.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” u miratua shtesa e fondeve për zërin Investime në masën 2.42 miliardë Lekë.

Fondi total i akorduar për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 është 3.877 miliardë Lekë.

Struktura përbërëse e fondit në vlerë sipas Shpenzimeve Korrente dhe Kapitale.




Realizimi i Fondit total të Buxhetit të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021 deri në datën 31 Dhjetor 2021:

Në Lekë

N r	ZERAT E BUXHETIT	Miratuar	Shpenzuar
I	PAGAT	300,000,000	272,740,690
1	Pagat personelit te perkohshem ne KQZ	80,000,000	77,289,748

2	Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, ZR, trajnuesve te KZZ,KQV,GNV	220,000,000	204,376,250
II	MALLRA & SHERBIME	631,000,000	<u>612,659,302</u>
II I	INVESTIME	2,946,000,000	2,916,129,079
1	Kamera per sistemin video-monitorimin ne qendrat e votimit	394,000,000	371,766,936
2	Projekti pilot i votim numerimit elektronik ne KZAZ nr.40	125,813,257	119,087,712
3	Projekti i identifikimi elektronik i zgjedhësve	2,426,186,743	2,425,274,431
	TOTALI	3,877,000,000	<u>3,801,529,071</u>

Paraqitja grafike e realizimit të Buxhetit të Zgjedhjeve sipas Shpenzimeve Korrente dhe Kapitale deri ne datën 31 Dhjetor 2021



Çelja e fondeve nga Ministria e Financave u krye brenda afatit të domosdoshëm për kryerjen e të gjitha procedurave prokuruese, në vijim të kësaj përdorimi i fondeve të miratuara të buxhetit të zgjedhjeve, u realizua në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Fondi për Paga, Sigurime dhe Shpërblime

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, Nr.69/2020, Datë 16.11.2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për periudhën zgjedhore”, u krye deklarimi i ndryshimit të numrit të punonjësve të përkohshëm, në sistemin elektronik tatimor për rreth 300 persona, si dhe u përgatitën listëpagesë shtesë për këtë kategori çdo muaj.

Fondi për Pagat personelit të përkohshëm dhe Shpërblimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, ZR, trajnuesve u realizuan në masën 91 %.

Diferenca prej 27 milionë lekësh ka lidhje kryesisht me:

- Numrin e qendrave të votimit. Ishin parashikuar 5500 qendra votimi, u ngritën 5199 qendra votimi. Kostoja e një QV-je është 25000 Lekë * 300 QV = 7.5 milionë Lekë - diferenca e papërdorur e fondeve
- Pagesa e trajnuesve. Koha e trajnimit ishte shumë e ngushtë me ditën e zgjedhjeve dhe nuk u plotësuan të gjitha ditët e parashikuara për trajnim. Diferenca e papërdorur e fondeve është 6 milionë Lekë

- Vjetërsia në vite pune e trajnuesve. Jo i gjithë personeli i kontraktuar kishte vjetërsi pune maksimale. $7000 \text{ lekë/muaj} * 225 \text{ persona} * 4 \text{ muaj} = 6.3 \text{ milionë lekë}$ - diferenca e papërdorur e fondeve.

Fondet e Administruara nga KZAZ

Për zgjedhjet për për Kuvend të datës 25 Prill 2021, u transferuan pranë njësive vendore, fondet si më poshtë:

Shpenzime për transportin e bazës materiale KZAZ-QV-KZAZ, KZAZ-KQZ,	13,604,000 lekë
Shpenzime për shpërblimin e komisionerëve të KZAZ, KQV, GNV,	195,551,000 lekë
Shpenzime për QV me qera,	4,656,000 lekë
Shpenzime për VNV me qera,	100,000 lekë

Në total 213,911,000 lekë



Referuar pikës d, nenit 33, të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja “Administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja”, pothuaj 1/3 e buxhetit që i akordohet për realizimin e procesit zgjedhor, KQZ-ja nuk e menaxhon vetë, por nëpërmjet Ministrisë së Financave duke e transferuar këtë fond në njësitë vendore ku operojnë Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor.

KQZ-ja konfirmon shumat përkatëse që do të transferohen në çdo njësi vendore, të cilat kundrejt procedurave të tyre kryejnë pagesat ndaj përfituesve. Njësitë vendore duhet të kryejnë pagesën kundrejt dokumentacionit të paraqitur nga komisionerët e ZAZ-ve në zyrat e njësive vendore (borderotë për shpërblimet e komisionerëve, faturat për transportin e bazës materiale si dhe kontratat e qerave për ambientet private).

KQZ-ja nuk është direkt përgjegjëse për mënyrën e shpërndarjes së këtyre fondeve drejt përfituesve finalë, por ajo udhëzon njësitë vendorë për mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve.

Procedura e transferimit të fondeve realizohet në tre faza, sipas llojit të shpenzimeve që mbulohen me këto fonde. Dy faza kryhen përpara datës së zgjedhjeve dhe faza e tretë pas përfundimit të procesit të zgjedhjeve:

- Transferimi për shpenzime transporti të bazës materiale nga KZAZ në QV dhe anasjelltas,
- Transferimi për shpërbimin e komisionerëve të KZAZ, KQV, GNV si edhe shpenzime qeraje,
- Transferimi për pagesën e QV në ambiente private

Fondi për mallra dhe shërbime zgjedhore

Fondet publike në dispozicion për mallra dhe shërbime zgjedhore ishin 631 milionë lekë. U realizuan në masën 97% duke u përdorur për blerjen e bazës së materiale zgjedhore:

Fletë votimi & shabllonë të posacëm për votuesit e verbër,

Kode sigurie,

Bojë timbruese,

Vula për KZAZ-të dhe KQV-të,

Dhoma të fshehta,

Kuti kartoni për transportin e bazës materialë zgjedhore,

Shtypshkrime,

Kancelari,

Materiale promocionale (postera, fletëpalosje, kapele, bluza, stilolapsa etj)

Për shërbime të ndryshme, në funksion të zgjedhjeve:

Shërbim për implementimin dhe menaxhimin e sistemit të kamerave,

Transportin e bazës matëriale zgjedhore,

Udhëtime dhe dieta të administratës,

Njoftime të ndryshme në media të lidhura me procesin zgjedhor,

Ambjente me qera për VNV, QV

Mjete transporti me qera, si p.sh autobus për transportin e punetorëve KQZ-Lundër,

Shërbime për programet aplikativë të informacionit parazgjedhor,

Shërbim për përditësim dhe asistencë për programet aplikativë për rezultatet,

Shërbim për përditësimin dhe printimin e hartave,

Shërbim për siguri fizikë me roje private,

Shërbim të ndryshme,

Transmetimi i fushatës edukuese, informuese, sensibilizuese në media

Brenda zërit Mallra, për Mallra-Materiale (shtypshkrime), kemi një tejkalim të fondit të parashikuar, i cila ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe risive në fushën e teknologjisë dhe informacionit të cilat për herë të parë u implementuan në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Gjithë procesi i sigurimit të bazës materiale dhe shërbimeve zgjedhore, nuk pati ndonjë problematikë për t' u shënuar. Baza materiale zgjedhore u sigurua në kohë, mallrat u lëvruan sipas afateve të përcaktuara në kontratat përkatëse, u pranuan, u regjistruan konform procedurave kontabël të u bënë hyrje në magazinë dhe u paguan brenda afateve të parashikuara.

Realizimi i zërit Investime është në masën 99% të fondit të dhënë për këtë zë.

Në lidhje me programin buxhetor "Planifikim Menaxhim & Administrim" me Kod 01610 situata financiare për vitin 2021, paraqitet si vijon:

Emërtimi	Plani Fillestar Buxhetor në Lekë	Plani Buxhetor i Rishikuar në Lekë	Realizimi financiar në Lekë	Realizimi në përqindje
Shpenzime Korrente	165.000.000	166.236.000	158.104.000	95
Shpenzime Kapitale	16.500.000	16.500.000	16.405.000	99

2. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në funksion të misionit për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, ka detyrimin ligjor për sigurimin e të gjithë bazës logjistike zgjedhore (mallra dhe shërbime). Duke qenë se në pjesën më të madhe të tyre logjistika zgjedhore përdoret vetëm për zgjedhjet e radhës (fletë votimi, kode sigurie, zarfe dhe procesverbale etj.), sigurimi i tyre kërkon zhvillimin e procedurave prokuruese.

Procedurat prokuruese të parashikuara, janë në varësi jo vetëm të miratimit të strukturës buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 por edhe të vendimmarrjes së organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimmarrja e KQZ-së konsiston dhe në miratimin e modeleve dhe specifikimeve përkatëse teknike të artikujve të kërkuar, pa një vendimmarrje të tillë është e pamundur të procedohet me blerjen e mallrave apo shërbimeve që nevojiten për zgjedhjet.

Vendimmarrje e cila, në raste të caktuara kërkon dakordësinë e partive politike dhe reflektimin e rekomandimeve të partnereve ndërkombëtar (p.sh: fleta e votimit, identifikimi elektronik, projekti pilot votim numërimi, kamerat në qv). Nisur nga ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor por edhe konstituimi i organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka filluar më datë 05 Tetor 2021 koha e ngelur në dispozicion të KQZ-së për përshtatjen dhe miratimin e akteve nënligjore në funksion të procesit zgjedhor ka qenë jo favorizuese.

Nga 16 dhjetor 2020 deri në 20 prill 2021, organet e KQZ kanë marrë 15 (pesëmbëdhjete) vendime për mallra dhe shërbime në funksion të organizimit të zgjedhjeve dhe janë ende për tu marrë vendime të cilat përcaktojnë në thelb specifikimet teknike, të cilat i paraprijnë procedurave prokuruese.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2021, u zhvilluan 23 procedura prokurimi, nga të cilat 21 të llojit “procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, 1 procedurë e llojit “kërkesë për propozim elektronikë” dhe 1 procedurë me VKM të posaçme (spotet). Procedurat janë realizuar në harkun kohor Dhjetor 2020 – Prill 2021. Në përfundim të procedurave prokuruese me operatorët fitues u nënshkruan kontrata dhe u lëvrua malli apo shërbimi i kërkuar.

Ndër mallrat dhe shërbimet e kërkuara risi për këto zgjedhje ishin Identifikimi elektronik i zgjedhësve, Votimi dhe numërimi elektronik dhe kamerat në qendrat e votimit. Futja e teknologjisë në zgjedhje domosdoshmërisht do të përkthehet dhe në procedura prokuruese me qëllim qëndrueshmërinë e zhvillimit të këtyre projekteve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datë 23 mars 2021 zhvilloi procedurën prokuruese “Sisteme video monitorimi në qendrat e votimit” e cila u shpallur më datë 10 Mars 2021 dhe kontrata me kompaninë fituese u lidh më datë 07 Prill 2021.

Seksioni III: Teknologjia në zgjedhje

1. Identifikimi Elektronik

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve menjëherë pas konstituimit të organeve të reja drejtuese me datë 31.10.2020, Komisioni Rregullator miratoi vendimin nr. 2 mbi “Llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. Po në këtë datë ngrit grupin e punës *për vlerësimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit*. Në përfundim të raportit të grupit të punës në datë 21.12.2020 nxori Urdhrin e Prokurimit me nr. 49, datë 23.12.2020, për procedurën prokuruese “Sisteme/pajisje të teknologjisë së informacionit për identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin e tyre paszgjedhor”.

Menjëherë pas nxjerrjes së Urdhrit të Prokurimit, KQZ vijoi procesin e prokurimit me objekt “Sisteme/pajisje të teknologjisë së informacionit për identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin e tyre pas zgjedhor”.

Për vlerësimin e kostos së këtij projekti, KQZ kërkoi nga 22 kompani me reputacion në këtë fushë një vlerësim i përafërt i kostos së projektit prej të cilave 7 kompani iu përgjigjën kërkesës së KQZ për llogaritjen e kostos financiare. KQZ ju dërgoi ftesën 5 kompanive që kishim dërguar një përlllogaritje kostoje në fazën e parë të këtij projekti, ndërsa për dy prej tyre të cilat nuk rezultuan të regjistruara në sistemin e prokurimit elektronik, i udhëzoi ato të regjistroheshin në APP por mosangazhimi i tyre detyroi administratën e KQZ-së të vijonte procedurat e mëtejshme.

Kompanitë e ftuara janë:

1. TCN (Tirana, ALBANIA)
2. CIELA NORMA (Sofia, Bullgari)
3. HSB IDENTIFICATION (Ëoerden, The Netherlands)
4. THALES GROUP, Thales DIS France SA (Prague, Czech Republic)
5. SMARTMATIC (London, UK)
6. IDEMIA (SAFRAN MORPHO), (Paris, FRANCE)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor, ka zhvilluar procedurën prokuruese për përzgjedhjen e shoqërisë që do të realizojë identifikimin elektronik të votuesve dhe identifikimin e tyre paszgjedhor. Në përfundim të procedurës prokuruese, fituese u shpall shoqëria “Smartmatic International Holding B.V”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas negociatave me kompaninë fituese mbi kushtet e veçanta të kontratës që do të lidhet mes palëve, dhe pas këshillimit me Avokaturën e Shtetit në lidhje me draft-kontratën e negociuar mes palëve dhe pas kalimit të fondeve në llogarinë e autoreiteti kontraktor në datë 10 Shkurt 2021 u lidh kontrata me kompaninë fituese.

Për herë të parë, siç ishte dhe parashikuar në ndryshimet e kodit të ri zgjedhor, KQZ implementoi sistemin e identifikimit elektronik në të gjitha qendrat e votimit ditën e zgjedhjeve. Sistemi i ri i implementuar është sistem identifikimi elektronik me nënshkrim biometrik.

Qëllimi i këtij sistemi të ri ishte parandalimi i:

- votimit të dyfishtë,
- votimit familjar ose
- votimit për një zgjedhës tjetër.

Objektivi i sistemit elektronik ishte identifikimi korrekt i zgjedhësve për zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021, duke siguruar identifikimin e zgjedhësve në mënyre të sigurtë, transparente si dhe duke rritur rendimentin e veprimeve në qendrat e votimit.

Sistemi Elektronik Identifikimit të Votuesve përfshin 3 komponentë:

- i. PEI, Pajisjen Elektronike të Identifikimit; një pajisje e integruar, portabël dhe e specializuar e cila përmban liste elektronike të zgjedhësve me të gjithë komponentët e nevojshëm për të bërë të mundur një proces identifikimi të sigurtë dhe eficient.
 - ii. VIUClient; programi i specializuar për identifikimin e zgjedhësve i instaluar në Pajisjen Elektronike të Identifikimit.
 - iii. Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve I cili përbehet nga 2 komponentë:
 - a. Sistemi Qendror i Identifikimit të Votuesve, i cili bën të mundur përgatitjen dhe konfigurimin e PEI.
 - b. Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik, i cili menaxhon procesimin e të dhënave biometrike, deduplikimin dhe detektimin e rasteve të dyshuara si votim i dyfishtë.
- Çdo pajisje e identifikimit elektronik përmban listat e plote të zgjedhësve.
 - Zgjedhësit u identifikuan nëpërmjet letërnjoftimeve ose pasaportave.
 - Verifikimi i identitetit u bë në mënyrë elektronike për 97% të qendrave të votimit, duke skanuar kodin MRZ nga pajisja e identifikimit elektronik.
 - Si pjesë e procesit të identifikimit u bë dhe skanimi i gjurmëve të gishtërinjve i cili zëvendësoi nënshkrimin në listën e zgjedhësve, ky skanim u ruajt në memorien e pajisjes e me pas u transferua në serverin qendror të SEIV për verifikime të mëtejshme pas zgjedhore.
 - Sistemi i prokuruar sipas dhe raportit nga Odihri plotësoi objektivat ligjorë dhe teknike të vendosura në rregulloret përkatëse.

Duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër brenda së cilës duhej të implementohej ky projekt rrethanë e cila nuk ishte në favor të KQZ-së, projekti i Identifikimit Elektronik u implementua brenda një harku kohor prej 2 muajsh e gjysëm.

Gjate kësaj periudhe ndër të tjera u implementuan dhe pikat e mëposhtme:

- Importimi i Pajisjeve dhe Serverave. Konfigurimi i Pajisjeve dhe Serverit sipas specifikimeve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
- Ngritjen e platformës online për rekrutimin e Operatoreve teknik të PEI dhe trajnuesve të operatoreve. Përzgjedhjen nga rreth 17000 aplikanteve dhe rekrutimin e mbi 5200 operatorëve prej tyre. Përzgjedhjen dhe rekrutimin e 62 trajnuesve.
- Trajnimin e 70 trajnuesve të jashtëm si dhe stafit të KQZ javën e parë dhe të dytë të muajit Prill. Trajnimin e rreth 5200 operatorëve në 26 qytete të Shqipërisë në një hark kohor 10 ditor kryesisht prej 62 trajnuesve të jashtëm të supervizuar prej stafit të përhershëm dhe të përkohshëm të KQZ, si dhe trajnimeve online gjatë ditëve të fundit përpara zgjedhjeve.
- Transportimi i të gjitha pajisjeve drejt KZAZ-ve, përfshirë këtu dhe pajisjet rezervë që u përdorën nga stafi teknik i kompanisë për zëvendësim në rast difekti gjatë ditës së zgjedhjeve.
- Transportimi dhe diagnostikimi i pajisjeve për 292 QV më të largëta në zonat më të thella të Shqipërisë prej teknikeve të kompanisë.
- Demonstrimin publik të funksionaliteteve dhe testimin e pajisjeve në prani dhe të mediave në 3 qytete; Tiranë, Kukës dhe Fier.

KQZ realizoi me sukses në masën 100% të përgatitjes dhe disponueshmërinë me Pajisjet e Identifikimit Elektronik për të gjitha QV në të gjitha KZAZ. Ditën e zgjedhjeve PEI u aktivizuan në 5023 qendra votimi, e për pjesën e mbetur prej 176 të QV-ve me proces manual identifikimi kryesisht për shkak të mungesës së operatorëve apo probleme të tjera të natyrës teknike ose proceduriale.

Referuar kërkesave të Kodit Zgjedhor u krye testimi publik më datë 14 Prill për 3% të pajisjeve të prokuruar, në seance publike në prani të mediave. Gjatë seancës, të gjitha pajisjet i kaluan të gjitha testet dhe rezultuan funksionale.

Pas procesit zgjedhor të datës 25 Prill u tërhoqën të gjitha pajisjet prej KZAZ-ve dhe u transportuan drejt magazinave të KQZ prej nga ku u transferua informacioni nga çdo PEI drejt serverit SEIV për qendërzimin e të dhënave dhe verifikimin e tyre paszgjedhor. Pas konsolidimit të të dhënave në server, stafi i KQZ filloi procesin e kryqëzimit i cili realizohet nga komponenti ABIS (Automated Biometric Identity System). Rastet e gjeneruara nga sistemi pas verifikimit nga stafi i KQZ iu referuan organeve të prokurorisë për procedim penal.

2. Pajisjet Elektronike të Votimit dhe Numërimit

Edhe për këtë kërkesë të re të Kodit Zgjedhor, KQZ me datë 31.10.2021 ngriti grupin e punës për vlerësimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit”. Me datë 13.11.2020 Komisioni Rregullator Miratoi vendimin nr, 4 “ Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numrimit elektroni që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionit Rregullator me vendimin nr. 04, në datë 12.02.2021, vendosi se projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave do të realizohet, në një nga Zonat e Administrimit Zgjedhor në Bashkinë e Tiranës, e cila duhet të ketë në juridiksion territorial të saj, jo më shumë se 55 Qendra Votimi. Për sa më sipër, lindi e nevojshme përlllogaritja edhe një herë e fondit limit për këtë procedurë prokuruese duke qenë se pas miratimit të vendimit të parë të Komisionit Rregullator, përlllogaritja u krye bazuar në kërkesën ligjore për 1055 QV.

Në vijim të procedurave, është nxjerrë urdhri i prokurimit nr. 56/1, datë 03 mars 2021, për procedurën prokuruese “Sisteme/pajisje të teknologjisë së informacionit për votimin dhe numërimin e votave”, me fond limit 109,999,500 (njëqind e nëntë million e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, kërkuar nga Buxheti i Shtetit.

KQZ ju dërgoi ftesën 3 kompanive të përzgjedhura nga grupi i punës në përlllogaritjen e fondit limit dhe kompanisë e cila shprehu interes për të marrë pjesë:

1. CGTS (Miami, USA)
2. CIELA NORMA (Sofia, Bullgari)
3. SMARTMATIC (London, UK)

Publikimi i procedurës është realizuar në datë **04 Mars 2021** dhe lidhja e kontratës me kompaninë e shpallur fituese u realizua në **datë 29 Mars 2021**.

Edhe pse në një periudhë kohore mjaft të ngjeshur u realizuan të gjitha procedurat e prashikuara dhe përgjithësisht mallrat u lëvruan brenda afateve kohore të pritshme, çka ndihmoi në përpunimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e bazës materiale të logjistikës zgjedhore drejt komisioneve të niveleve të tjera (KZAZ, KQV).

3. Akses i publikut në KQZ, transparenca

3.1 Faqja zyrtare e KQZ në web “kqz.gov.al”

Faqja web e KQZ është një nga kolonat më të rëndësishme të detyrave funksionale të institucionit në raport me administrimin dhe realizimin e zgjedhjeve transparente dhe brenda standardeve. Një nga detyrat Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për Veprimtarinë e KQZ-së ishte ndërrimi i “domain” të faqes web të KQZ nga “cec.org.al” në “kqz.gov.al”, detyrë e cila u realizua me sukses.

Faqja web e KQZ u ndërtua tërësisht e re, me një strukturë interaktive në raport me informacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm për zgjedhësit, subjektet politike dhe palët e interesuara. Në faqen web u pasqyruan të gjithë vendimet e KSHZ, KRR, KAS si dhe rezultatet zgjedhore në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar për subjektet politike dhe kandidatët respektivë. Faqja web shërbeu si një dritare ndërvepruese me qytetarin dhe palët e interesuara në proces, gjithashtu edhe si mundësi aplikimi për punonjësit e përkohshëm, të nevojshëm për procesin zgjedhor.

Faqja elektronike zyrtare kqz.gov.al ishte lehtësisht e aksesueshme dhe funksionale për subjektet politike, shoqërinë civile dhe publikun.

Për çdo seancë publike të tre organeve të KQZ-së, është kryer zbardhja, korrektimi dhe redaktimi i procesverbaleve nga regjistrimi audio, të cilat janë pjesë e vendimeve të këtyre organeve. Në total janë zbardhur procesverbalet për;



- 495 vendime dhe 15 udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- 33 vendime dhe 4 udhëzime të Komisionit Rregullator;
- 111 vendime të KAS

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë vitit 2021 rriti transparencën institucionale. KQZ përdori të gjithë mjetet dhe format e komunikimit për të përcjellë informacion dhe mesazhe. Përdori mediat sociale dhe ato tradicionale përmes intervistave, bashkëbisedimeve periodike, deklaratave, takimeve online, e të tjerë. KQZ rriti sasinë dhe cilësinë e informacionit të përcjellë tek publiku.

- i. Aplikacioni KQZ – KQZ në bashkëpunim me Këshillin e Evropës lançoi aplikacionin KQZ për platformat IOS dhe Android si një platformë informimi dhe komunikimi mes KQZ-së dhe administratës zgjedhore. Aplikacioni shërbeu për të gjetur vendndodhjen dhe itinerarin e qendrave të votimit, për të denoncuar parregullsitë e konstatuara gjatë procesit zgjedhor, informacione mbi procedurat dhe plotësimin e fletës së votimit, e të tjerë.
- i. Përmirësoi profilet zyrtare në rrjetet sociale “Facebook”, “Tëitter”, “Instagram”, “Linkedin”, “YouTube” duke rritur ndjekshmërinë dhe interaktivitetin e publikut me KQZ.
- ii. Publikoi në kohë të gjithë projektaktet para zhvillimit të mbledhjeve dhe aktet pas miratimit të tyre në faqen zyrtare (vlerësuar pozitivisht edhe në Raportin e OSBE/ODIHR).
- iii. Çdo mbledhje e organeve drejtuese të KQZ-së u transmetua në kohë reale në kanalin “YouTube”, “Facebook” dhe faqen zyrtare me cilësi të lartë audio-video.
- iv. Për herë të parë, KQZ publikoi të gjithë procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve të KSHZ, KRR dhe KAS në faqen zyrtare.
- v. Rezultatet paraprake të zgjedhjeve u transmetuan në kohë reale në faqen zyrtare të KQZ-së dhe në Qendrën e Mediave në KQZ. Media pati si burim kryesor të informacionit të dhënat e KQZ-së dhe raportuan live nga QM. Vetëm gjatë ditëve të numërimit të votave 25-29 prill 2021, në faqen zyrtare ka patur 164 mijë përdorues të pandërprerë.

Statistika – KQZ App 2021

IOs 5K (5000 shkarkime) / Android 10K+ (mbi 10.000 shkarkime)



Statistika –WEB 2021



3.2 Ndërfaqe për raportimin e veprimtarive publike

Kodi i ri zgjedhor ngarkoi KQZ me detyrën e ngritjes së një ndërfaqja (portal) në web, ku nëpërmjet së cilës të gjithë institucionet shtetërore të raportonin aktivitetet e tyre duke përcaktuar datën, orën, vendin dhe aktivitetin. Ky portal u realizua nga KQZ brenda afatit të përcaktuar në ligj, që ishte data 25 Dhjetor 2021 dhe nëpërmjet të cilit të gjithë institucionet publikuan aktivitetet e tyre. Ndërfaqja (portali) u ndërtua në formë interaktive, ku publikimet e aktiviteteve realizoheshin nëpërmjet personit të caktuar nga vetë institucioni, ndërsa KQZ e monitoronte nëpërmjet ekstraktit që nxirrej në mënyrë automatike nga platforma e ndërfaqes (portalit).

3.3 Modulet e nevojshme në Web për procesin zgjedhor

KQZ ka detyrime të cilat i përcakton Kodi Zgjedhor mbi ngritjen e disa moduleve në faqen web, dhe që shërbejnë për transparencën e procesit zgjedhor në lidhje me formularët e dekriminalizimit,

raportimin financiar të partive, denoncimet dhe kallëzimet. Këto module u realizuan brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Me implementimin e pajisjeve elektronike të identifikimit të zgjedhësve (PEI) në këto zgjedhje, lindi nevoja e ngritjes së një moduli në faqen web të KQZ, i cili do të shërbente për aplikimin e punonjësve të përkohshëm që do të shërbenin për administrimin e këtyre pajisjeve. Moduli u ndërtua në formë interaktive në mënyrë të tillë që çdo i interesuar ta dërgonte vetë formën e aplikimit duke plotësuar fushat përkatëse. Moduli i jepte mundësinë KQZ-së që të nxirrte në mënyrë periodike një ekstrakt të përmbledhur të të gjithë aplikuesve duke përcaktuar zonën për të cilën kanë aplikuar (qarkun, njësinë administrative arsimin, moshën), etj. Më poshtë renditen modulet e realizuara me propozimet e nevojshme për përmirësim (nëse ka nevojë).

- Moduli për paraqitjen e formularëve të dekriminalizimit për kandidatët e subjekteve zgjedhore dhe kandidateve të pavarur.
- Moduli për denoncimet dhe kallëzimet.
- Moduli i raportimit financiar të partive.
- Moduli i aplikimit të personelit të përkohshëm për procesin zgjedhor.

3.4 Paraqitja gjeografike dhe administrative e hartave zgjedhore në web

Pasqyrimi në web i hartave zgjedhore të të gjitha niveleve është standard mbi transparencën e procesit zgjedhor si dhe një ndihmesë e madhe për zgjedhësit, ku nëpërmjet aplikacionit “KQZ” mund të gjenin vëndodhjen e qendrës së votimit në të cilën kanë për të votuar. Ky proces është konsideruar përherë një standard tepër i rëndësishëm duke pasur parasysh se një numër jo i vogël i qendrave të votimit ndryshojnë vëndodhjen nga një palë zgjedhje në një tjetër si pasojë e lëvizjeve demografike të popullsisë ku për të njëjtën arsye edhe zgjedhësi mund të mos votojë në të njëjtën qendër të zgjedhjeve të mëparshme. KQZ realizoi përcaktimin e koordinatave të çdo qendre votimi, edhe pse bashkitë ndryshuan vëndodhjen e një numri të konsiderueshëm qendrash votimi pas afateve kohore, si pasojë e tërmetit ose të një arsyeje tjetër objektive. Më poshtë paraqiten tipet e hartave zgjedhore të publikuara në web.

- Qendrat e Votimit (vëndndodhja e qendrave të votimit me koordinatat përkatëse)
- Harta për secilën ZAZ (gjeografike, administrative)
- Harta për secilën Njësi Administrative (gjeografike, administrative)
- Harta për secilën Bashki (gjeografike, administrative)
- Harta për secilin Qark (gjeografike, administrative)

3.5 Informimi mbi përqindjen e votimit dhe “Struktura Call Center”

Informimi mbi përqindjen e votimit periodikisht nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, çdo një orë gjatë ditës së votimit, nga të gjitha qendrat e votimit për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 ishte një risi që

vendosi një standard të ri mbi transparencën dhe informimin e publikut dhe palëve të interesuara mbi procesin zgjedhor.

Gjatë administrimit të procesit zgjedhor, një element tepër i rëndësishëm për zgjidhjen e problematikave të ndryshme, informimit ose njoftimeve është ngritja e strukturës teknike “Call Center”. Në këto zgjedhje punonjësit që shërbenin nëpërmjet kësaj strukture komunikuan me operatorët dhe komisionerët e të gjitha qendrave të votimit duke iu dhënë atyre informacionin e nevojshëm për zgjidhjen e situatave të paqarta ose duke i informuar mbi administrimin në mënyrë korrekte të pajisjeve teknike si PEI, PEVN dhe kamera gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve.

4. Sistemet e informacionit zgjedhor

Sistemet për administrimin dhe publikimin e informacionit zgjedhor janë jo vetëm nevojë për mirë administrimin e procesit zgjedhor në tërësi, por për disa elemente të procesit janë një domosdoshmëri e standardit për transparencën dhe detyrimet që ka KQZ në bazë të Kodit Zgjedhor. KQZ implementoi me sukses dy sistemet e mëposhtme:

4.1 Sistemi i menaxhimit të informacionit parazgjedhor

Sistemi aplikativ është i përberë nga një sërë modulesh që shërben për administratën e KQZ-së. drejtoritë e KQZ-së. Nëpërmjet moduleve përkatëse drejtoritë kryejnë detyrat e tyre funksionale në lidhje me administrimin e informacionit parazgjedhor të tilla si të dhëna për subjektet politike, kandidatet e subjekteve politike, kandidatet e pavarur, koalicionet, informacionin e nevojshëm për përgatitjen e përmbajtjes së fletëve të votimit, zonat zgjedhore, qarqet, bashkitë, njësitë administrative dhe qendrat e votimit. Gjithashtu nëpërmjet këtyre moduleve administrohet informacioni i komisionereve të zonave të administrimit zgjedhor, komisionereve të qendrave të votimit si dhe të gjithë punonjësve të përkohshëm të KQZ-së të nevojshëm për procesin zgjedhor.

4.2 Sistemi i përpunimit dhe transmetimit në kohë reale të informacionit zgjedhor

Gjatë procesit të numërimit të votave dhe publikimit në faqen zyrtare të KQZ në Web u shfrytëzua ky sistem për përlogaritjen dhe publikim e rezultateve paraprake zgjedhore. Sistemi funksionon në një rrjet të mbyllur “intranet” nëpërmjet të cilit dërgohet informacioni i rezultateve paraprake gjatë numërimit të votave nga çdo Vend Numërimi i Votave në KQZ, verifikohet nga filtrat logjik dhe publikohet në faqen e KQZ në web në kohë reale. Ky sistem është tejet i domosdoshëm për transparencën dhe për publikimin në një kohë sa më të shkurtër të rezultateve zgjedhore. Nëpërmjet po këtij sistemi realizohet përlogaritja e të dhënave dhe paraqitja në Web e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

5. Kamerat në zgjedhje dhe transmetimi video në kohë reale

5.1 Kamera për regjistrim video të procesit të votimit në 5199 QV

Gjatë zgjedhjeve për kuvend të datës 25 Prill 2021, në zbatim të Kodit Zgjedhor, KQZ vendosi të rrisë nivelin e kontrollit dhe të transparencës gjatë procesit zgjedhor duke vendosur regjistrimin e

pamjeve video të procesit të votimit nëpërmjet kamerave në të gjithë qendrat e votimit. KQZ tregoi kujdes të veçantë që të ruhej fshehtësia e votës gjatë procesit të votimit të zgjedhësve duke i vendosur kamerat në një lartësi të kufizuar ku nuk kishte pamje video në dhomat e fshehta të votimit. Teknologjia e përdorur ishte e nivelit bashkohor dhe pamjet video të regjistruara të një cilësie teknike me rezolucion të lartë. Gjatë procesit të votimit në zgjedhjet për kuvend të datës

5.2 Kamera për regjistrimin video të procesit të numërimit të votave në 92 VNV

Regjistrimi video i procesit të numërimit të votave është përcaktim ligjor dhe standard mbi transparencën dhe besueshmërinë e procesit të cilin KQZ e realizon që prej disa zgjedhjesh. Regjistrimi video i numërimit të votave është vlerë e shtuar e besueshmërisë së procesit zgjedhor. Sistemi i regjistrimit të procesit të numërimit të votave si dhe transmetimi në kohe reale i pamjeve video të tavolinave të numërimit të votave në KQZ, në zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021 u realizua plotësisht dhe pa asnjë problematike, ndërprerje ose mungesë informacioni video. KQZ administroi plotësisht pamjet video për të 92 Vendet e Numërimit të Votave dhe iu përgjigj të gjitha kërkesave të subjekteve politike të interesuara, kandidatëve të pavarur dhe kandidatëve të subjekteve politike. Në këto zgjedhje u rrit niveli teknologjik dhe cilësia e parametrave teknik të regjistrimit për pamjet filmike video të numërimit të fletëve të votimit.

Seksioni IV: Lista e Zgjedhësve, Caktimi i Mandateve, Zonat e Administrimit Zgjedhor

1. Lista e zgjedhësve

Lista e zgjedhësve është element tepër i rëndësishëm i procesit zgjedhor. Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar qartë se cilat janë institucionet përgjegjëse për listën e zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dhe bashkitë, si dhe rolin që i jepet KQZ për të kontrolluar dhe menaxhuar në përgatitjen përfundimtare të kësaj liste. Për kontrollin, verifikimin dhe nxjerrjen e problematikave të ndryshme të listës së zgjedhësve, KQZ ngarkon me detyrë dy ekspertë të jashtëm. Në lidhje me përgjegjësitë që i ngarkon Kodi KQZ për listën e zgjedhësve, KQZ ka kryer detyrat e mëposhtme:

1.1 Komunikimi dhe kontrolli periodik mujor (6 muaj) i listës së zgjedhësve të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) si dhe nga pushteti lokal.

1.2 Bashkërendim me ekspertet e jashtëm të KQZ për kontrollin e listës së zgjedhësve si dhe publikim në web i raportit të tyre mujor.

1.3 Pasqyrimi në web i listës së zgjedhësve në bashkëpunim me DPGJC dhe “E-albania”.

1.4 Gjetja e qendrës së votimit të zgjedhësve në web ose nëpërmjet aplikacionit mobile “KQZ”.

2. Ndarja e ZAZ-ve

Mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhësve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile u miratua ndarja e Zonave Zgjedhore (ZAZ). Në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 Zonat e Administrimit

Zgjedhor u rritën nga 90 që ishin në zgjedhjet pararendëse në 92, si rrjedhojë e rritjes së numrit të lejuar të votuesve për një ZAZ të caktuar, siç është e përcaktuar në Kod Zgjedhor. Ndarja e ZAZ-ve u realizua brenda afatit të përcaktuar kohor.

3. Përcaktimi i mandateve për çdo qark

Në zbatim të përcaktimeve ligjore, Komisioni Rregullator miratoi numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish. Numri total i shtetasve, sipas Regjistrisë Kombëtare të Gjendjes Civile, pjesëtohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar, të përfutur nga pjesëtimi i numrit total të shtetasve me numrin 140 të mandateve në Kuvend.

Seksioni V: Trajnimi i administratës zgjedhore dhe grupeve të interesit

1. Organizimi i trajnimit të administratës zgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes miratimit të programit të trajnimit të administratës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, synoi mirorganizimin e trajnimit për të gjithë nivelet e administratës zgjedhore.

Përgatitja e udhëzuesve me fletore pune përkatëse reflektuan:

- ndryshimet e Kodit Zgjedhor;
- kuadrin nënligjor të miratuar nga KQZ;
- procedurave të reja ligjore;
- dispozitat e Kodit Penal për vepra penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet;
- menaxhimin e të gjitha situatave në KQV dhe duke dhënë mënyrat e zgjidhjes së tyre;
- mënyrën e administrimit të votës në kutinë e gabuar.

Në udhëzuesin e KQV, u përfshi edhe parashikimi i procedurave për rastet e problematikave lidhur me identifikimin elektronik dhe mënyrat e përdorimit të pajisjes PEI, procedura të cilat do të mbaheshin në vëmendje nga anëtarët e KQV-së.

Përgatitja e videos së trajnimit të KQV, me mbështetjen e UNDP-së, testonte nivelin e njohurive të marra gjatë leksionit dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të KQZ-së vinte në ndihmë të çdo të interesuari.

Shpërndarja e materialeve të trajnimit paraprakisht me e-mail, bëri që trajnimi të ishte më interaktiv, pasi trajnuesit u familjarizuan me përmbajtjen dhe u fokusuan në problemet, duke sjellë shembujt konkret të hasura në zgjedhjet e kaluara. Kjo solli rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së trajnimit.

2. Zhvillimi i trajnimit

Në sesionet e trajnimit të KZAZ-ve dhe KQV-ve vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të temave për garantimin e fshehtësisë së votës, ndalimin e votimit familjar dhe në grup, rastet e fotografimit të votës, ndalimin e votimit më shumë se një herë [timbrimi], zgjedhësit që për arsye fizike nuk mund të votojnë vetë etj, të cilat u demonstruan përmes simulimeve, dhe identifikimit elektronik dhe përdorimit të pajisjes PEI, vendosjen e posterave për fletët e votimit dhe masave anti covid dhe aplikacioni KQZ.

Gjithashtu pjesë e trajnimeve për komisionet e KQV-ve ishin edhe detyrat e operatorit në përdorimin e pajisjes PEI dhe kamerave në QV, me qëllim që administrata zgjedhore të ishte e mirinformuar për veprimtarinë e tyre.

Trajnimi dhe testimi i njohurive për anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve u realizua më 22.03.2021 dhe 23.03.2021, menjëherë pas plotësimit të përbërjes së KZAZ-ve me propozimet e partive politike të opozitës parlamentare.

Nga 736 komisionerë (kryetarë, zv/kryetarë, sekretarë, anëtarë) gjithsej në rang vendi u trajnuan 721 komisionerë prej të cilëve 219 ishin gra dhe 502 burra.

Zhvillimi i trajnimit për anëtarë të KQV-ve u realizua në datat 18-23 prill 2021, në një kohë që udhëzuesi për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 u miratua nga Komisioni Rregullator në datën 12 prill.

Përgjatë periudhës 6 ditore të trajnimeve nga 36.393 komisionerë (kryetarë, sekretarë, anëtarë) gjithsej në rang vendi u trajnuan 17.828 prej të cilëve 4620 ishin gra dhe 13.416 burra.

Gjatë ditëve të trajnimit për komisionerë të KQV-ve, sidomos në ditën e parë, problematikat që u hasën kishin të bënin me sigurimin e infrastrukturës. Në ditën e parë të trajnimit rezultoi se 30 shkolla në të gjithë Republikën e Shqipërisë nuk ishin hapur në orarin e fillimit të trajnimit, për arsye të mos koordinimit midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe drejtorive arsimore rajonale e zyrave arsimore.

Gjithashtu, zëvendësimi i anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve sidomos ditën e zgjedhjeve, pas trajnimit të tyre nga KQZ, solli ekzistencën e komisionerëve të patrajnuar. Ka rezultuar se mosparaqitja e komisionerëve për t'u trajnuar në kohën dhe vendin e trajnimit është në një shkallë të gjerë.

Skema e trajnimit nuk parashikonte mekanizma mitigues për rastet e zëvendësimit të komisionerëve, duke qene se ato zhvilloheshin ad hoc vetëm për një periudhe të kufizuar kohore.

Trajnimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave hasi në vështirësi për shkak të propozimeve tejet të vonuara nga subjektet zgjedhore dhe miratimit me vonesë të udhëzuesit të trajnimit.

Ky trajnim së bashku me trajnimin e anëtarëve të KZAZ-ve për procedurat e numërimit u zhvillua nga datat 24.4.2021 deri me date 26.4.2021 dhe në disa KZAZ deri më datë 28.4.2021 në një kohë që udhëzuesi u miratua nga Komisioni Rregullator me datë 20.4.2021.

Caktimi i anëtarëve të GNV-ve përgjithësisht u krye në momentin përpara fillimit të procesit të numërimit të votave dhe trajnimi i tyre ishte i detyruar të kryhej në Vendet e Numërimit të Votave përpara fillimit të numërimit. Në rang vendi, u ngritën 854 grupe të numërimit të votave, dhe u caktuan 3,434 numërues të grupeve të para dhe të dyta të numërimit. 84% e numëruesve u trajnuan; numëruesit që nuk morën trajnim i përkisnin grupeve të dyta të numërimit, të cilët nuk u angazhuan në proces. Trajnimi i parashikuar për GNV-të për një periudhë 3 ditore, për shkak të ndryshimeve diktoi shtyrjen edhe me 2 ditë të tjera në disa KZAZ.

Zhvillimi i trajnimeve online me ToT dhe testimi i tyre elektronikisht me google forms lehtësoi menaxhimin e fazave me kritike për kryerjen e trajnimit për shkak miratimit në afate të ngushta të udhëzuesve të trajnimit të administratës si dhe kushteve të pandemise.

3. Trajnimet në kuadër të financimit të fushatës zgjedhore

KQZ ka organizuar trajnime të vazhdueshme lidhur me financimin e partive politike.

- Trajnim për monitoruesit e caktuar nga KQZ për monitorimin e fushatës zgjedhore me mbështetjen e KiE dhe NDI. Janë trajnuar në total 64 monitorues (32 gra dhe 32 burra) përse i përket mënyrës së plotësimit të shtojcave të raportimit të miratuara nga KQZ për monitorimin e fushatës zgjedhore si dhe për çdo shkelje të identifikuar.
- Trajnim për hetimin administrative në datat 26, 29 dhe 31 Mars 2021 me mbështetjen e KiE dhe NDI. Trajnimi kishte në fokus procedurën e hetimit administrativ të rasteve të ndryshme të shkeljeve ose sinjalizimeve që mund të denoncohen në portalin e dedikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Trajnimi për gazetarët mbi monitorimin e përdorimit të burimeve shtetërore dhe financimin e fushatës zgjedhore, i cili u zhvillua në datë 26 mars 2021 me mbështetjen e ASP.
- Trajnimin e stafit të KQZ nga Facebook mbi monitorimin e librarisë me të dhenat e shpenzimeve që bëjnë kandidatët dhe partitë politike në lidhje financimin e fushatës zgjedhore për publikimin në platformën e Facebook të reklamave të tyre elektorale, i cili u zhvillua në datë 19 prill 2021, me mbështetjen e NDI.
- Janë kryer trajnime me financierët e partive politike lidhur me mënyrën e përpilimit të raporteve financiare për t'u plotësuar për fushatën zgjedhore, si dhe për t'u prezantuar me udhëzuesit dhe formatet e miratuara nga KQZ për fushatën zgjedhore 2021, me mbështetjen e NDI.
- Trajnim mbi “Raportimin e auditimit për fushatën zgjedhore” me ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor) të përzgjedhur nga KQZ për të audituar fondet e përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike dhe kandidatët e tyre gjatë fushatës zgjedhore. Ky trajnim u zhvillua më datë 27 korrik 2021 në Vlorë, me mbështetjen e KiE.

Seksioni VI: Emërimi i administratës zgjedhore

1. Emërimi i komisionerëve dhe konstituimi i KZAZ-ve

KQZ monitoroi në dinamike të gjitha aktivitetet që lidhen me ngritjen dhe konstituimin brenda afateve ligjore të KZAZ-ve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, që do të ngriheshin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021 të cilat ishin PS, PD, LSI dhe PSD.

Brenda afateve ligjore vetëm Partia Socialdemokrate paraqiti propozime për anëtarë për 33 KZAZ. KQZ, në vakancat e krijuara në 59 KZAZ nga PSD, vendosi plotësimin e tyre me anëtarë nga subjekti i PS.

Subjektet zgjedhore kane paraqitur propozimet për 736 kandidatë për anëtarë KZAZ. Përgjatë periudhës rezultojnë këto të dhëna :

- Partia Socialiste ka propozuar emërimin e 276 anëtarëve në propozimet fillestare dhe 59 anëtarë (për shkak të vakancës së krijuar nga PSD);
- 276 anëtarë nga subjekti Partia Demokratike;
- 92 nga subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim dhe
- 33 nga Partia Socialdemokrate.

Mbledhja e parë e KZAZ-ve u zhvillua nga datat 27.1.2021 deri më datë 29.1.2021. Nga konstituimi dhe deri në përfundimin e procesit zgjedhor (nxjerrjes së rezultateve) në shumicën e KZAZ-ve janë zëvendësuar anëtarë me propozime të subjekteve zgjedhore përkatëse.

- PS ka zëvendësuar 66 anëtarë nga të cilët 43 burra dhe 23 gra
- PD ka zëvendësuar 42 anëtarë nga të cilët 32 burra dhe 10 gra
- LSI ka zëvendësuar 31 anëtarë nga të cilët 25 burra dhe 6 gra
- PSD ka zëvendësuar 18 anëtarë nga të cilët 14 burra dhe 4 gra


Gjithashtu janë propozuar nga subjektet zgjedhore rotacion në KZAZ (brenda KZAZ ose nga një KZAZ në tjetrën):

- PS 5 propozime për rotacion,
- PD 2 propozime,
- PSD 2 propozime,
- LSI 1 propozim.

Këto të dhëna tregojnë se administrata zgjedhore e nivelit të parë KZAZ ka pësuar ndryshime në rreth 22% dhe janë respektuar kërkesat e KZ për kuotat gjinore. Në këto zëvendësime ka patur edhe propozime të minutës së fundit, duke krijuar vështirësi në trajnimin dhe në performancën e tyre.

Raporti gjinor i administratës të nivelit të dytë, KZAZ-ve, ka qene sipas grafikut ne vijim:


RAPORTI GJINOR KZAZ



	PS	PD	LSI	PSD	Total
Raport gjinor KZAZ M	61%	72%	87%	67%	69%
Raport gjinor KZAZ F	39%	28%	13%	33%	31%


Në vitin 2021 rezultuan në tërësi 262 anëtarë nga 763 anëtarë të KZAZ-ve me përvojë të mëparshme në proceset zgjedhore. Përvoja e 262 anëtarëve të KZAZ-ve sipas subjekteve është si vijon:

Përvoja zgjedhore e anëtarëve të KZAZ-ve



Përvoja e 262 komisionereve të vitit 2021 në raport me 2 proceset zgjedhore me të fundit:

Përvoja zgjedhore e anëtarëve të KZAZ-ve, 2021




Raporti i përvojës së komisionerëve sipas subjekteve proponente:

	PS	PD	LSI	PSD	Total
Viti 2021	166	87	7	2	262
Raporti në Përqindje	60%	32%	8%	6%	36%


2. Emërimi i anëtarëve të KQV-ve dhe GNV

KZAZ respektuan formalisht afatet ligjore për emërimin e anëtarëve të KQV. Sipas të dhënave të dërguara nga KZAZ-të rezultojnë se deri ditën e zgjedhjeve janë ndryshuar 14-15% e anëtarëve të KQV nga listat fillestare të subjekteve politike, nga 30% që ka qenë trendi historik. I njëjti trend vërehet edhe në emërimet e anëtarëve të GNV, të cilët u emëruan dhe trajnuan ditën e numërimit të votave.


Raporti gjinor në bazë të të dhënave të përpunuara nga 96% të KQV-ve sipas subjekteve:



Raporti gjinor sipas propozimeve të vetë subjekteve



I njëjti trend përfaqësohet edhe në raportin gjinor të GNV-ve:



Në analizën e të dhënave historike një rol të rëndësishëm luan cilësia e të dhënave. Vendimmarrjet e KZAZ-ve për emërimin apo lirimin e anëtarëve të KQV-ve, janë vendimmarrje me shkrim dore dhe kjo vështirëson evidentimin e saktë të gjinisë apo edhe identifikimin e komisionerëve. Listat e dërguara në format elektronik shpesh herë përmbajnë gabime cilësore të cilat reflektojnë në përpunimin e të dhënave. Mungesa e një sistemi të propozimit, miratimit të anëtarëve të komisioneve të niveleve të dyta, ndikon edhe në cilësinë e përpunimit të të dhënave historike.

Seksioni VII: Edukimi i Zgjedhësve dhe Vëzhguesit

1. Edukimi i zgjedhësve

KQZ me 15 janar 2021 miratoi një program të detajuar për informimin, edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve, që ishte një program mjaft ambicioz, ku u përfshin të gjitha kategoritë e zgjedhësve, të rinjtë, votues për herë të parë, grupet vulnerabël, gratë etj. Programi synoi informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve, duke i informuar mbi ndryshimet në Kodin Zgjedhor, këtu u përfshin identifikimi elektronik, votimi elektronik, sensibilizimi i administratës publike për mospërfshirjen e tyre në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar, mospërdorimit të aseteve publike në favor të subjekteve zgjedhore dhe plotësimit korrekt të fletës së votimit. Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë” neni 15, paragrafi 4, të gjitha materialet që janë përdorur për sensibilizimin e zgjedhësve janë përkthyer edhe në gjuhën e pakicave kombëtare, sipas etnive kombëtare që ato janë pjesë në 8 gjuhë, përkatësisht në gjuhët greke, maqedonase, malazeze, bullgare, rome, vllahe, serbe, boshnjake edhe gjuhën e shenjave për personat me aftësi të kufizuar.

Programi i Edukimit ka pasur një bashkëpunimin shumë të ngushtë me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, si OSBE, KiE, NDI, ASP, Ambasada Britanike dhe organizata të ndryshme të Shoqërisë Civile.

Në bashkëpunim me zyrën e prezencës së OSBE në Tiranë është prodhuar spoti i parë me temë “Kontrollo emrin në Listën e Zgjedhësve”. Ky spot u shpërnda në të gjitha mediat e licensuara, radiot, rrjetet sociale, mediat online dhe materialet promociionale. Gjithashtu janë përdorur dhe mjete të tjera për shpërndarjen e informacionit zgjedhor si billboard, citylights dhe postera, të vendosura në pika me lëvizje të dendur të qytetarëve.

Billboard informuese u vendosën në të gjithë territorin e Republikës, dhe në gjuhën e minoriteteve, sipas përkatësive etnike së pakicave ku banon kjo pjesë e popullsisë.

Është zbatuar objektivi i dytë i programit për identifikimin elektronik, si një risi në zgjedhjet parlamentare të këtij viti. Për këtë qëllim, është prodhuar spoti për televizionet, radiot, mediat online, rrjetet sociale dhe materiale promociionale, shpërndarë në mediat lokale. Janë realizuar postera për identifikim elektronik të zgjedhësve, shpërndarë në rrjetet sociale, po ashtu u prodhuan posterat informues dhe u vendosën në çdo qendër votimi në të gjithë Shqipërinë, që zgjedhësit të ishin të mirëinformuar dhe në zonat ku banojnë pakicat kombëtare u vendosën edhe në gjuhën e tyre.

Është zbatuar objektivi i tretë i programit për procedurat e votimit që ndjek zgjedhësi në qendrën e votimit. Për këtë qëllim është prodhuar spoti që u transmetua në televizionet, radiot, mediat online, rrjetet sociale dhe materiale të tjera promociionale. Spoti u transmetua edhe në zonat e minoriteteve sipas gjuhës përkatëse, shoqëruar si në të gjitha rastet edhe me gjuhën e shenjave.

Posterat u vendosën në të gjithë pikat e lëvizjes së qytetarëve në të gjithë Shqipërinë; terminale dhe stacione të autobusëve urbane.

Në bashkëpunim edhe me KiE dhe në zbatim të pjesës së katërt të Programit të Edukimit është synuar rritja e pjesëmarrjes së të rinjëve, kryesisht votues për herë të parë, grave si dhe grupeve vulnerabël. Për këtë qëllim u përgatitën broshura informuese dhe postera për të rinjtë, si dhe takime online në formë bashkëbisedimi, me të cilët u diskutuan rëndësia e zgjedhjeve dhe e drejta e votës. Për këtë pikë të programit është prodhuar edhe spoti sensibilizues për romët. Nuk u lanë jashtë vëmendjes edhe institucionet e vuajtjes së dënimit (burgjet) për t'i informuar rreth të drejtës së tyre për të votuar. Gjithashtu u prodhua edhe pasaporta ndihmëse e zgjedhësit që u shpërnda në të 12 qarqet e vendit.

U zhvilluan aktivitetet me Këshillin Rinor të Ambasadës Amerikane. Të rinjtë e Këshillit Rinor filluan fushatën e tyre anti-korrupsion me serinë e Youth Talk ku Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve foli për ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe mekanizmat që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) përdor për të monitoruar partitë politike gjatë zgjedhjeve. Anëtarët e Këshillit Rinor bënë pyetje në lidhje me procesin e verifikimit të kandidatëve dhe hapësirat e përfshirjes së të rinjve në administrimin e procesit zgjedhor, gjithashtu të rinjtë u ftuan që të votojnë dhe të jenë qytetarë të angazhuar në mënyrë aktive!

Janë zhvilluar një sërë takimesh edukuese dhe informuese online me të rinjtë e Fakultetit të Mjeksisë, me të rinjtë e organizatës “Qendra Qytetare”, me të rinjtë, të rrjetit të profesionistëve të rinj, ku me mbështetjen e zyrës së OSBE dhe Këshillit të Europës në Tiranë u zhvillua një trajnim treditor me temë “Rinia aktive në procesin zgjedhor”, ku morën pjesë shumë të rinj. Në sesionet e edukimit dhe sensibilizimit ata u njohën me të gjithë hapat e procesit zgjedhor dhe kanë marrë informacione e nevojshëm si: identifikimi elektronik i zgjedhësve, procedurat e votimit, votimi dhe numërimi elektronik i zgjedhësve, në KZAZ nr.40, njësia nr. 10, që u përcaktua si njësia e zbatimit të këtij projekti pilot; plotësimi korrekt i fletës së votimit, që vota e tyre të jetë e vlefshme. Shfaqën shumë interes dhe drejtuan pyetje dhe shkëmbyen mendimet e tyre për këto zgjedhje.

Si fushatë edukuese, informuese dhe sensibilizuese, në Ditën Botërore të Zgjedhjeve, që përkoj më 4 shkurt 2021, slogani për këto zgjedhje u përzgjedh nga të rinjtë pas një konkursi që u zhvillua dedikuar tyre, në bashkëpunim me zyrën e prezencës së OSCE në Tiranë, vlen për tu theksuar se pjesëmarrja dhe interesi ishte i lartë.

Në bashkëpunim me Këshillin e Europës në 8 mars për të sensibilizuar gratë për pjesëmarrje në zgjedhje, u prodhuar një spot me mesazhe të grave ambasadore të disa vendeve të misioneve diplomatike në Shqipëri.

Në pjesën e pestë dhe të gjashtë të programit i është kushtuar vëmendje informimit të zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre. Për këtë qëllim në bashkëpunim edhe me zyrën e OSBE në Tiranë u prodhua dhe u shpërnda spoti për veprat penale, prodhim edhe në gjuhën e shenjave, shpërndarë

në televizione, radio, media online, rrjetet sociale dhe në materiale promocionale. Posterat për këtë qëllim janë shpërndarë në Tiranë, ku ka një përqendrim të popullsisë.

Ndërkohë, në bashkëpunim me këshillin e Europës dhe Akademinë e Studimeve Politike (ASP) u përgatit një material i detajuar për të gjithë administratën publike që u shpërnda si informacion për të gjithë titullarët e institucioneve shtetërore, ku u informuan nëpunësit publikë, lidhur me veprimet e ndaluara gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu u prodhuan dhe u shpërndanë edhe posterat informues dhe sensibilizues që u vendosën në të gjitha institucionet shtetërore të vendit.

Pjesa e shtatë e Programit të Edukimit i është kushtuar financimit të partive politike dhe zbatimit të legjislacionit, sipas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Për këtë pikë të programit është vënë në dispozicion portali i denoncimeve, duke ftuar çdo individ, apo subjekt për çdo shkelje të kujdo force politike. Në bashkëpunim me NDI, u prodhua një spot që informon publikun mbi shkeljet e partive politike. Po kështu në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe Akademinë e Studimeve Politike janë prodhuar postera informues mbi transparencën financiare dhe mbikëqyrja e fushatës zgjedhore. Spoti dhe posterat janë shpërndarë edhe në rrjetet sociale KQZ.

Menjëherë pas Vendimit të kolegjit Zgjedhor të gjykatës së Apelit Tiranë, KQZ filloi transmetimin e spotit informues, "Për mënyrën korrekte të plotësimit të fletës së votimit", në televizione, televizione lokale, radio, media sociale dhe në emisionet më të ndjekura të mbrëmjes. Kjo si nevojë për informim të shtuar të zgjedhësve dhe ndryshimeve që pesoi fleta e votimit shumë afër datës së zgjedhjeve të 25 prillit.

Për shkak të situatës së pandemisë Covid -19, të gjitha materialet e prodhuara dhe posterat që u vendosën në qendrat e votimit u shoqëruan me masat, bazuar në protokollet e sigurisë që janë miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Për këtë qëllim së bashku me OSBE u realizuan posterat për Qendrat e Votimit (QV) dhe Vendet e Numërimit të Votave (VNV).

Ditën e Zgjedhjeve u mbajtën kontakte të vazhdueshme me organizatat e shoqërisë civile, me OJF që vëzhgonin zgjedhjet, nëse informacioni zgjedhor, posterat ishin të vendosura në çdo qendër votimi në të gjithë vendin, gjithashtu edhe në gjuhën e pakicave në zonat ku ata banojnë.

Në përfundim të zgjedhjeve të 25 prillit 2021 KQZ ka vazhduar aktivitetet sensibilizuese në kuadër të fushatës edukuese të zgjedhësve duke hartuar programin e punës për periudhën jo-zgjedhore. Drejtorja e Komunikimit zhvilloi takime periodike me bashkëpunëtorë ndërkombëtarë për të vijuar me zhvillimin e aktiviteteve me zgjedhësit. Përgjatë gjithë periudhës pas zgjedhore, kryesisht në muajt tetor, nëntor, dhjetor kanë vijuar takimet/ aktivitetet me gratë, me të rinjtë në gjimnaze, grupet vulnerabël, si dhe me personat me aftësi të kufizuar të shtrira në të gjithë vendin.

Në Shkodër, u zhvillua aktivitet me gratë, ku pjesëmarrja ishte shumë e lartë dhe ku u bashkëbisedua për të drejtën e tyre në zgjedhje, të drejtën e votës, paanshmërinë për të votuar, përfshirja e tyre në proceset vendimarrës.

Filloi zbatimi i programit të edukimit për të rinjtë votues për herë të parë për periudhën jo-zgjedhore, ku së bashku me të gjitha Drejtoritë Arsimore në rang vendi përgatitëm sesionet e edukimit në shkollat e mesme, kryesisht të viteve të dyta dhe të treta, të cilët do të jenë votues për

herë të parë. Në lidhje me këtë objektiv të programit të edukimit u përgatit një plan pune për të zhvilluar takimet në gjimnaze, në të gjithë vendin në bashkëpunim edhe me organizata të Shoqërisë Civile, me të cilët bashkëpunimi ka qenë i vazhdueshëm.

Misioni ynë në lidhje me edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve do të vazhdojë gjithmonë, si në periudhë zgjedhore dhe në periudhë jozgjedhore.

2. Vëzhguesit e huaj dhe marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë

Përfaqësues të shoqërisë civile si dhe organizatave ndërkombëtare të cilët janë të angazhuar në zgjedhje kanë marrë pjesë në disa takime pune periodike online me ftesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ku kanë adresuar një sërë çështjesh, të cilat kanë patur vëmendje të shtuar lidhur me ecurinë e procesit zgjedhor. Kjo ka sjellë një transparencë të plotë të veprimtarisë së KQZ-së kundrejt çdo grupi interesi. Pozitiv është fakti që KQZ ka konsultuar në mënyrë të vazhdueshme organizatat lidhur me projekt-vendimet apo projekt-aktet e saj duke institucionalizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin efektiv me këto organizata.

Gjithashtu Komisioneri ka realizuar takime të rregullta të dedikuara me shumicën e ambasadorëve të vendeve të BE-së të akredituar në Tiranë, ku është raportuar rregullisht lidhur me përgatitjet e procesit. Ambasadori Soreca ka shprehur gatishmërinë e BE për të asistuar KQZ-në në detyrimet kryesore të saj si votimi elektronik dhe votimi nga jashtë vendit, ku pavarësisht vështirësive ligjore, teknike si dhe kohës në dispozicion delegacioni u tregua i gatshëm të ofrojë ekspertizën për KQZ-në. Dekriminalizimi ishte një çështje tjetër prioritare e diskutuar me Ambasadorën e SHBA, znj. Yuri Kim e cila ofroi mbështetjen e saj lidhur me parandalimin e rasteve në ofrimin e mesazheve të qarta për pastërtinë e kandidatëve të propozuar nga partitë politike në listat e tyre dhe të mos pasurit e njerëzve të inkrimuar në parlament. Mbështetje të procesit zgjedhor ofruan dhe ambasadori i Ambasadës Britanike mbi çështjen e financimit dhe edukimit zgjedhor si dhe Ambasadorja e Republikës Greke, Francës, Hollandës, Austrisë etj. Është mbajtur një kalendar i ngjeshur takimesh të Komisionerit si dhe të anëtarëve të KQZ-së me përfaqësues diplomatikë në vend.

Takime janë zhvilluar me ekspertëve të huaj të çështjeve zgjedhore, përfaqësues të organizmave të ndryshëm si OSBE, Këshilli i Evropës, UNDP, NDI, KShH, SHKD, KRIIK etj. Në këto takime janë shkëmbyer informacione në lidhje me procesin përgatitor zgjedhor, vështirësitë e hasura, nevojat etj.

Për të qenë sa më transparent dhe për t'u ardhur në ndihmë vëzhguesve dhe çdo organizate të huaj të interesuar, janë përkthyer në anglisht dhe publikuar në website ëëë.kqz.gov.al vendimet e KQZ-së si dhe të gjitha njoftimet e nxjerra para dhe gjatë procesit zgjedhor.

Për t'i ardhur në ndihmë vëzhguesve, vendas dhe të huaj u përgatit një Udhëzues ku përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e një vëzhguesi. Gjithashtu vëzhguesi me anë të këtij udhëzuesi merr

informacion të mjaftueshëm mbi sistemin zgjedhor në Shqipëri, administrimin e zgjedhjeve dhe të gjitha procedurat që ndiqen. Udhëzuesi u publikua në website-in e KQZ-së.

Akreditimi i vëzhguesve

Për ndjekjen e procedurave të akreditimit të vëzhguesve vendas dhe të huaj, u bazuam në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”.

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), ngriti më 18 mars një Mision të Kufizuar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MKVZ) i kryesuar nga Ambasadorja Urszula Gacek, i përbërë nga 13 specialistë të vendosur në Tiranë dhe 24 vëzhgues afatgjatë të vendosur në të gjithë vendin që prej datës 26 mars.

Gjithashtu organizata të ndryshme vendase ndoqën procesin zgjedhor me fokus në aspekte të ndryshme të procesit, duke përfshirë përdorimin e burimeve shtetërore, administratën zgjedhore dhe financat e fushatës.

KQZ-ja akreditoi për zgjedhjet për Kuvend 25 prill 2021 ne total 3656 vëzhgues: 248 vëzhgues afatgjatë, 2,026 vëzhgues afatshkurtër si dhe 1199 përfaqësues të Medias.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor Misioni i ODIHR doli me Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake më 26 prill 2021 – Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (OSCE PA) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE).

Raporti ofroi një serë rekomandimesh që duhet të plotësohen nga autoritetet, që zgjedhjet parlamentare të 2023 në Shqipëri të jenë "në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike". Raporti final u publikua me 26 korrik 2021. Vlerësimi i OSBE/ODIHR është pa diskutim vlerësimi më pozitiv i dhënë ndonjëherë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Më datën 30 shtator 2021 u zhvillua një vizitë folloë-up e Misionit të ODIHR me Komisionerin, Rregullatorin dhe KAS ku u diskutua mbi rekomandimet e nxjerra si dhe të merreshin parasysht kërkesat dhe pretendimet e KQZ-së.

Roli i Komisionit Qendror të zgjedhjeve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve edhe pse në afate të ngushta kohore për realizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, mundi të zbatonte të gjitha rekomandimet kyçe të OSBE/ODIHR të raportit të vitit 2019.

Në datën 9 dhjetor 2021 u zhvillua në formë video konferencë (on-line), Takimi i 12-të i Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA), Bashkimi Evropian – Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë takim përfaqësuesi i KQZ raportoi lidhur me Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit dhe transparencës (përqendrimi dhe zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe financimin e partive politike).

Ndarja e eksperiencave pozitive për çështje të rëndësishme zgjedhore si dhe adresimi i problematikave të hasura kanë qenë në fokus të aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2021 si: pjesëmarrja në Konferencën e 30-të vjetore e ACEEEO-s organizuar nga Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë e cila u përqendrua në dy tema kryesore: Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhje dhe Fushata dhe financimi i partive, Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale në Kosovë si dhe vëzhgimi i raundit të dytë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut ku u vëzhguan nga afër procesi i identifikimit të votuesve dhe aspekteve të tjera nga delegacioni shqiptar

Trajnimi dhe Zhvillimi i ndihmon institucionet të përmirësojnë produktivitetin dhe të kenë rezultate me të larta, dhe të rrisin kënaqësinë dhe moralin në punë, KQZ-ja ka organizuar dhe ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh e aktiviteteve.

Gjatë vitit 2021, për shkak të pandemisë së COVID-19 shumica e trajnimeve dhe aktiviteteve u kryen online. Këto trajnime kanë patur një variacion të gjerë të tematikave dhe ideve të diskutuara e shkëmbyera përfshijnë experiencat e zgjedhjeve, diasporën, teknologjinë e informacionit, median, financimin e partive politike dhe tematika të tjera si më poshtë:

Diaspora

- Tryezë e rrumbullakët | Votimi nga Jashtë Vendit organizuar nga GERMIN mbi Prezantimin e raportit mbi Votimin Jashtë Vendit në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 14 shkurt 2021

Edukimi

- Trajnim organizuar nga përfaqësues të Departamentit të Komunikimit të Kryeministrit të Britanike dhe agjensisë TOK me tematikë 'Edukimi i të rinjve në kuadër të projektit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.
- Trajnim në lidhje me aplikacionin e CANVA organizuar nga përfaqësues të Departamentit të Komunikimit të Kryeministrit të Britanike dhe agjensisë TOK.
- Konferenca e 30-të vjetore e ACEEEO -s me dy tema kryesore: Pjesëmarrja e të rinjve dhe Fushata dhe financimi i partive.
- Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe KQZ-ja organizuan takim edukues, informues dhe sensibilizues me gratë në Shkodër, për procesin zgjedhor.

- KQZ-ja organizoi një takim me personat me aftësi të kufizuar në lidhje me fushatën e edukimit zgjedhor.
- Trajnim organizuar nga Ambasada Britanike në Tirana në lidhje me shkencat e sjelljes, cilat janë sjelljet që duam të ndryshojmë, komunikimin dhe motivimi.
- Takim me të rrinj organizuar nga NDI Albania në lidhje me praktikën studentore.

Financimit e Partive Politike

- Roundtable organizuar nga ODIHR për mbikqyrjen financiare të partive politike.
- Trajnim organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe NDI në lidhje me raportimin e auditimit për fushatën zgjedhore.
- Workshop organizuar nga NDI në lidhje me komunikimin e financave politike (rregullave, detyrimeve të subjekteve zgjedhore, gjetjeve nga raportet financiare etj.) tek publiku.
- Trajnim për pikat e kontakti antikorrupsion organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Sektori i Programeve Antikorrupsion dhe Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion.
- Aktivitet i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Projektit të Asistencës Teknike për Koordinimin Kombëtar Kundër Korrupsionit të Delegacionit të BE-së në Tiranë me tematiken Legjislacioni shqiptar në lidhje me Sinjalizimin dhe mbrojtja e sinjalizuesit.
- Takimi i 4-rt i Komitetit Drejtues të KiE për Projektin "Veprimi kundër krimit ekonomik".
- Workshop organizuar nga NDI në lidhje me Korniza Strategjike dhe Operacionale e KQZ-së. Planifikimi strategjik dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e financimit të partive politike.
- Takim dhe diskutim me e Znj. Tuija Brax, Drejtore e Klinikës Ligjore në Universitetin e Helsinkit, Filande dhe Znj. Blerita Hoxha, perfaqesuese e International IDEA, rreth Dixhitalizimi/IT I KQZ-se dhe transparenca e financimit të partive politike.
- Konferenca e 30-të vjetore e ACEEEO -s me dy tema kryesore: Pjesëmarrja e të rinjve dhe Fushata dhe financimi i partive

Teknologjia e Informacionit

- Webinar Ndërkombëtar organizuar nga Foresight Democracy me tematikë për votimin dhe regjistrimin në internet: raste studimore, teori dhe teknologji.
- Konferenca Ndërkombëtare online organizuar nga KQZ e Rumanisë së bashku me ACEEEO me tematikën “Good practices in the management of electoral processes: 2019-2020. Focus on two important topics: the realities of running the elections and ensuring transparency in electoral management.”
- Webinar Ndërkombëtar organizuar nga World Election Bodies (A-WEB) dhe International Centre for Parliamentary Studies (ICPS) me tematikën “Elections & Technology: How to Incorporate New Systems into Our Electoral Processes.”

- Trajnim organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me AKSHI-n për sistemin që do të përdoret për pritjen e aplikimeve për kërkesat dhe kthimin e përgjigjeve për qytetarin nëpërmjet portalit e-Albania.
- Trajnim organizuar nga ILDKP, USAID and CE Trajnim në lidhje me Sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit.
- Vëzhgimi i procesit të identifikimit të votuesve dhe aspekteve të tjera nga delegacioni shqiptarë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut.
- Takim dhe diskutimi me e Znj. Tuija Brax, Drejtore e Klinikës Ligjore në Universitetin e Helsinkit, Filande dhe e Znj. Blerta Hoxha, përfaqësuese e International IDEA, rreth Dixhitalizimi/IT I KQZ-se dhe transparenca e financimit të partive politike.

Media

- Webinar Ndërkombëtar organizuar nga International Foundation for Electoral Systems në lidhje me “Good Practices and Lessons Learned on Countering Disinformation during Electoral Processes” Workshop for the Social Media, Disinformation, and Electoral Integrity (SMEID) eorking Group.
- Vëzhgim i procesit të zgjedhjeve lokale në Kosovë.
- Tryezë të rrumbullakët organizuar nga BIRN me aktorë nga institucionet monitoruese të zgjedhjeve, publike dhe joqeveritare, të fokusuar në rekomandimet dhe nevojën për ndryshime lidhur me monitorimin e mediave sociale, online dhe audiovizive gjatë fushatës elektorale, si dhe rolit të tyre në mbikëqyrjen e financave të partive politike.
- Workshop organizuar nga BIRN dhe Ambasada Britanike në Tiranë në lidhje me Monitorimi i medias: Sfidat dhe mundësitë për zgjedhjet në të ardhmen në Shqipëri.

Shoqëria Civile

- Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, mbështetur financiarisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim paraqiti Raportin për Indeks të Integritetit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 25 prill 2021.
- UN Women në Shqipëri, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, paraqitën prezantimet e gjetjeve të raportit të monitorimit.

Zgjedhjet

- Webinar Ndërkombëtar organizuar nga IFES me temë “Rezistenca e Demokracisë në Europë Përgjatë Pandemisë”.
- Webinar organizuar nga ASPA për Legjislacionin në BE.
- Trajnim organizuar nga IFES me Metodologjinë BRIDGE.
- Përfaqësues nga KQZ ishin vëzhgues afatshkurtër të zgjedhjeve STO/VASH në Maqedoninë e Veriut.

- Trajnim online nga European Centre for Electoral Support “Preventing-Mitigating-Managing Electoral Conflicts and Conflict Mapping”

Janë zhvilluar aktivitete me shoqërinë civile ndër te cilat vlen të theksohet INSIZ për paraqitjen e Raportit për Indeks të Integritetit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 25 prill 2021. Takime me organizatat ndërkombëtare, NDI, IDEA, BIRN, UN Women në Shqipëri etj. lidhur me Kornizën Strategjike dhe Operacionale të KQZ-së, planifikimin strategjik dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e financimit të partive politike et

Seksioni VIII: Objektet zgjedhore dhe ambientet e punës të administratës zgjedhore

1. Selitë e KZAZ-ve

Selitë e KZAZ-ve në përgjithësi u krijuan në të njëjtën vendndodhje si dhe të atyre në zgjedhjet 2019. Bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore, ka qenë efikas dhe u janë përgjigjur me korrektësi kërkesave ligjore si për caktimin e ambienteve dhe të kriterëve që ato duhet të plotësojnë (dhe në përputhje me masat anticovid në kushtet e një realiteti ndryshe për shkak të virusit SARS-CoV) si dhe sigurimin e bazës së nevojshme logjistike.

Në total rastet e raportuara për vonesa në vënien në dispozicion të ambienteve që do të përdreshin për seli KZAZ ishin 7.

Disa seli KZAZ të propozuara nga bashkia nuk kishin as aksesin për të hyrë lirshëm në ambientin e përcaktuar si seli KZAZ.

2. Qendrat e Votimit

Përgjatë procesit të verifikimit të QV dhe plotësimit të kriterëve ligjore nga komunikimi me bashkitë ka rezultuar se 429 QV kanë sipërfaqe më të vogël se 30 metër katror, 35 qv pa rrjet elektrik, 23 QV pa dritare dhe 26 QV të vendosura në kat të dytë ishin me zgjedhës PAK.

KQZ, bazuar në propozimet e Kryetarëve të Bashkive, shqyrtoi dhe vendosi miratimin e 389 QV-ve në ndërtesa private.

Pasojat e tërmetit të vitit 2019 dëshmuar se pushteti vendor nuk shfaqti nivel të lartë sensibiliteti për respektimin e kërkesave të Kodit Zgjedhor, duke kërkuar ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve, edhe pas afatit 40 ditor para datës së zhvillimit të zgjedhjeve. Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor ndryshimi i vendndodhjeve të QV 40 ditë para datës së zgjedhjeve bëhet vetëm për rastet e arsyeve madhore.

Referuar kërkesave nga kryetarët e bashkive, janë dhënë autorizime për ndryshimin e 105 vendndodhjeve të QV-ve në ambiente private me 3 (tre) vendime. Bashkia Tiranë dhe Durrës kanë patur kërkesat me numrin më të madh të ndryshimit të vendndodhjeve të QV respektivisht me 67 dhe 32 QV.

Ndryshimet e shpeshta të vendndodhjeve të QV dhe mosrakhordimi i informacionit në faqen e KQZ-së, me aplikacionin KQZ që furnizohej me të dhëna nga E-Albania, ndikuan në cilësinë e informacionit për zgjedhësit mbi vendndodhjen e QV.

Aksesi i PAK në QV ishte në vëmendje të veçantë, jo vetëm të shoqërisë civile, por edhe të KQZ-së. Ndonëse para ditës së zgjedhjeve nuk pati asnjë raportim konkret për mungesën e rampave në QV të caktuara, referuar raporteve të monitorimit nga grupet e interesit raportohet për mungesa dhe kërkohet rishikimi i udhëzimit nr 1 datë 5.12.2020 te Komisionit Rregullator per kriteret e përcaktimit te QV-ve, duke marrë në konsiderate aksesin e PAK në ambientet e QV.

Nga të dhënat e disponuara nga pushteti vendor rezultoi se ishin në total rreth 35,995 persona me aftësi të kufizuar me vendndodhje në 43 KZAZ/ 3643 QV. Me gjithë angazhimin dhe seriozitetin e punuar për krijimin e kushteve për persona me aftësi të kufizuar, ky mbetet në vijimësi një problem që kërkon vëmendje.

3. Infrastruktura dhe energjia për QV dhe VNV

Implementimi i teknologjisë në zgjedhje diktoi domosdoshmërinë e garantimit të energjisë elektrike në çdo qendër votimi dhe rrjedhimisht edhe komunikim intensiv me kryetarët e njësive të qeverisjes vendore dhe OSHEE, për të garantuar furnizimin me energji për çdo qendër votimi.

Problematikat konsistuan në mungesën e furnizimit me energji elektrike, apo të infrastrukturës së nevojshme në këto QV për të implementuar pa pengesa teknologjinë në procesin e votimit PEI dhe kamera. OSHEE raportoi prezencën e mungesës së furnizimit të rregullt me energji për 104 QV.

KQZ bashkërendoi të gjitha problematikat e QV në bashkëpunim me OSHEE dhe pushtetin vendor dhe monitoroi në dinamike situatën deri në zgjidhjen dhe konfirmimin përfundimtar të tyre.

Nga bashkërendimi i problematikave dhe ndjekjes së tyre me pushtetin vendor nuk pati QV pa energji elektrike.

4. Vendet e Numërimit të Votave

Vendndodhja e VNV-ve në këto zgjedhje ishte thujtë e njëjtë me ato të zgjedhjeve pararendëse, me përjashtim të VNV e ZAZ-së nr.52 dhe VNV e ZAZ-së 48 të qarkut Elbasan të cilat u vendosën në palestra gjimnazesh të sapondërtuara. Nga 92 VNV vetëm 1 VNV është miratuar në ambient privat për arsye se asnjë objekt publik nuk plotësonte kriteret.

Ndryshimet e vendndodhjeve të VNV kanë ndodhur në 7 raste me arsyetimin për kushte më të mira dhe në plotësim të kriterëve për shkak të Covid-19.

Infrastruktura e kamerave në VNV u krijua në kohe, ndërsa në 7 KZAZ për shkak të ndryshimeve të vendodhjes së tyre grafiku i shpërndarjes u riplanifikua duke cënuar edhe grafikun e implementimit të teknologjisë së kamerave në VNV.

5. Administrimi operacional i dokumentacionit të KZAZ-ve

KZAZ ndonëse kishin detyrim të paraqisnin në KQZ vendimmarrjet dhe listat e komisioneve të QV dhe GNV nën juridiksionin e tyre, jo të gjithë e realizuan këtë detyrim. Në bazë të raportimeve

sporadike nga bashkitë për pagesat e administratës zgjedhore u konstatua se informacioni i paraqitur nga KZAZ-të në KQZ ishte e paplote.

KZAZ dorëzuan në KQZ dokumentacionin e kërkuar në vendimmarrjen e KQZ-së, bazën materiale zgjedhore të përdorur në votim në magazinat në Lundër dhe në protokollin e KQZ-së. KZAZ-të në disa raste kane lënë edhe dokumente administrative të pa kërkuara nga aktet e KQZ-së (të tilla si dokumentacionin mbështetës për propozimet e subjekteve dhe kandidatëve për KQV/ GNV, propozimet për vëzhgues si dhe vendimet për caktimin e tyre).

Këto problematika të vërejtura dëshmojnë se administrimi manual i dokumentacionit duhet ri dimensionuar në kuadër të përdorimit të teknologjisë në automatizimin e disa proceseve administrative në vend të përdorimit të mënyrave manuale të administrimit të dokumentacionit.

Seksioni IX: Infrastruktura dhe materialet zgjedhore

1. Përgatitja i materialeve zgjedhore/ mjeteve logjistike dhe infrastrukture për zhvillimin e zgjedhjeve.

KQZ funksionoi mbi bazën e një sistemi të centralizuar të organizimit, përpunimit, transportit dhe mbledhjes së dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore duke u mbështetur në burime dhe institucione që kanë mundësi të garantojnë një infrastrukturë të tillë, siç është Ministria e Mbrojtjes. Në aspektin e sigurisë së transportit të fletëve të votimit ajo u asistua nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Përgjithësisht, ky proces zgjedhor nuk ka patur problematikë të ngritur apo qoftë edhe të pretenduar për sa i përket materialeve zgjedhore. Por për shkak të afateve ligjore që përcakton Kodi Zgjedhor, sigurimi dhe përpunimi i tyre brenda një kohe shumë të shkurtër mbetet një problem me të cilin u përballëm dhe në këtë proces zgjedhor.

Vendimet që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori për miratimin e modeleve, specifikimeve apo procedurave që lidhen me administrimin materialeve zgjedhore u miratuan në një kohë optimale, referuar dhe kalendarit të punës për vendimmarrje, fakt që ndikoi që procedurat për sigurimin tyre të realizoheshin në kohë bazuar edhe në kërkesat buxhetore të studiara dhe të argumentuara.

Procedurat e administrimit të PEI dhe kamerave ishin nder dokumentet e miratuara pak kohe para shpërndarjes së bazës materiale dhe shkaktoi një ngarkesë të shtuar të komisionet e administratës zgjedhore.

Përgatitja e materialit zgjedhor kërkon hapësira të nevojshme për kryerjen e gjithë proceseve të përpunimit dhe paketimit të BMZ. Aktualisht KQZ administron 4 magazina në Lundër ku përpunohet dhe përgatitet baza materiale zgjedhore, por në këto zgjedhje një nga këto magazina u ri konstruktua (magazina nr. 4) e cila u përdor nga firma SMARTMATIC për vendosjen e pajisjeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve pajisjet (PEI).

Në këto kushte përpunimi i bazës materiale për dorëzimin dhe shpërndarjen e bazës materiale u krye në dy magazinat (nr. 1 dhe nr. 2). Mbas mbarimit të procesit zgjedhor në këto magazina janë administruar dhe kamerat të cilat janë në pronësi të KQZ, (në total për 5199 QV dhe 92 VNV), kështu që këto hapësira janë ngushtuar mjaft dhe për zgjedhjet e ardhshme nuk kemi ambiente të mjaftueshme në dispozicion për përgatitjen e bazës materiale zgjedhore. Duke marrë në konsideratë interesin e subjekteve politike për të rritur investimet në përdorimin e teknologjisë në zgjedhje ky shqetësim behet edhe me eminent.

2. Mjetet dhe materialet për KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të

Materialet dhe dokumentacioni bazë që përgatitet për procesin zgjedhor, kryesisht për KZAZ-të, GNV-të dhe KQV-të është i përcaktuar në detaje nga Kodi Zgjedhor, fakt që nuk lë hapësirë për problematikë.

KQZ vuri në dispozicion të KZAZ/ GN gjithë infrastrukturën e nevojshme në bashkëpunim dhe bashkërendim me DADTSI dhe subjektet e kontraktuara

Shpërndarja e bazës materiale zgjedhore u zhvillua në 3 etapa.

Etapa e parë kishte të bënte me ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhore (KZAZ) në datën 27 janar 2021. Për këtë u përgatit dhe u shpërnda baza materiale zgjedhore e cila iu dërgua 92 KZAZ-ve.

Etapa e dyte u krye përgjatë periudhave 12.04.2021-14.04.2021 dhe shërbeu për dërgimin e bazës së nevojshme për masat Anticovid, duke nisur me pajisjen e cdo KZAZ-je, KQV-je dhe VNV-je me numër të konsiderueshëm alkool dezinfektues, xhel, maska, doreza. Gjithashtu një vëmendje iu kushtua dhe posterave të përgatitura për këtë qëllim.

Sasia e posterave për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 ishte në një numër më të lartë, si nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ashtu dhe nga OSBE-ja, kjo dhe për shkak të masave Anticovid.

Etapa e tretë u krye nga data 22.04.2021-24.04.2021 dhe u bë respektivisht shpërndarja e kutive me fletët e votimit dhe bazës materiale zgjedhore duke angazhuar 55 kamionë (të vegjël, të mëdhenj dhe të mesëm) për 92 KZAZ-te. Rritja në numër e sasisë së kamionëve ka ardhur si pasojë e masave anticovid për KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të.

Mjetet e transportit të përdorur nga ushtria ishin të një teknologjie jo të përshtatshme për ngarkimin e bazës materiale për shkak të profilit të tyre, dhe nuk garantonin integritetin e BMZ në rastin e përkeqësimit të kushteve klimaterike. Nga ana tjetër transportimi i tyre në dy raste ka demonstruar avari, që vështirësuan operacionet për shpërndarjen e bazës materiale.

Një problematikë në këtë etapë të procesit ka qenë marrja në dorëzim e PEI, si nga KZAZ-të dhe KQV-të, pasi nuk ishin të njohur me procedurat e marrjes dhe dorëzimit të PEI-t.

Një risi pozitive në këto zgjedhje ishte edhe prodhimi i sasisë shumë më të vogël të vulave rezervë, pasi në çdo vit zgjedhor ato prodhoheshin në numër të barabartë me numrin e QV-ve. Këtë vit numri në total ishte 600 vula rezervë dhe nuk u përdor asnjë vulë rezervë në këto zgjedhje, nga të 92 KZAZ-të.

Seksioni X: Regjistrimi i subjekteve, fushata zgjedhore dhe integriteti zgjedhor

1. Regjistrimi i subjekteve

Partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit respektuan afatet e aplikimit për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore. Procesi i regjistrimit të subjekteve zgjedhore garuese në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, përfshin disa procese, duke filluar nga verifikimi formal dhe përmbajtësor i dokumentacionit të kandidimit, kthimi për plotësim/korrigjim, hartimi i projektakteve për korrigjim, rivefikim i dokumentacionit të plotësuar/korrigjuar, dhe hartimi i projektaktit për regjistrim/refuzim. Elementet e këtij procesi ligjor janë si vijon:

- Regjistrimi i partive politike si subjekt zgjedhor
- Regjistrimi i koalicioneve si subjekt zgjedhor
- Regjistrimit i komiteteve nismëtare
- Regjistrimi i listave shumemërore të kandidatëve (verifikimi i numrit të kandidatëve në listë sipas numrit të mandateve për zonën zgjedhore, kuotës gjinore, formularëve të vetdeklarimit)
- Regjistrimi i kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Të dhëna statistikore për regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e 25 Prillit 2021:

- o U depozituan 49 kërkesa nga partitë politike për t'u regjistruar në zgjedhjet për Kuvend 2021, nga të cilat u regjistruan 46 parti politike
- o U regjistruan 8 komitete nismëtare
- o U regjistruan 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit
- o U regjistruan 10 subjekte zgjedhore (parti politike të cilat paraqitën listat shumemërore të kandidatëve)
- o U regjistruan 2 koalicione zgjedhore
- o Në total u regjistruan 1841 kandidatë për deputetë.

Procesi i verifikimit të dokumentacioni u realizua brenda afateve ligjore dhe në mënyrë të plotë dhe tërësore. Problematikat e vërejtura lidhen me:

- i. Vështirësi në verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit pas ridedepozitimit të listave të korrigjuara për shkak të afateve ligjore strikte.
- ii. Vonesa në marrjen e përgjigjeve nga DPGJC dhe DPB

2. Financimi i fushatës dhe integriteti zgjedhor

KQZ-ja administroi në mënyrë dinamike të gjithë procesin zgjedhor përmes mekanizmave të veçantë për të lehtësuar aksesin e të gjithë aktorëve (partive politike, OJF-ve dhe individëve) në raportimin/ denoncimin e shkeljeve zgjedhore, keqpërdorimet e burimeve publike, financimit të partive politike, nëpërmjet portalit të dedikuar në faqen e internetit të KQZ -së, adresës postare zyrtare, aplikacionit në celular (KQZ). Të gjitha denoncimet u trajtuan dhe u adresuan.

Ndërfaqja e raportimeve dhe ankimet administrative ndoqën hapat si vijon:

- Identifikimi dhe njoftimi i institucioneve përgjegjëse për raportimin e veprimtarive publike;
- Monitorimi i raportimeve në ndërfaqe,
- Administrimi i ankimeve nga portali “kallëzo”, posta elektronike zyrtare, aplikacioni “KQZ”, protokoli.
- krijimi i regjistrit të ankimeve administrative,
- vlerësimi i kompetencës (pranimi i ankimit, fillimi i procedurës, hetimi administrativ, vendimmarrja)

Institucionet raportuan aktivitetet, element ky që tregoi një ndergjegjësim të tyre në rritje. KQZ identifikoi institucionet përgjegjëse për raportim dhe u krijoi aksesin në ndërfaqe.

Në ndërfaqen e raportimeve u raportuan në total 1249 veprimtari të institucioneve publike. Pjesa më e madhe e institucioneve të cilat raportuan, nuk respektuan afatin e raportimit prej 5 ditësh.

Në këtë modul KQZ publikoi të gjitha denoncimet e paraqitura nga subjektet politike apo Organizatat e Shoqërisë Civile.

Moduli për denoncimet dhe kallëzimet u realizua sipas percaktimeve të Kodit Zgjedhor.

Moduli i raportimit financiar të partive u realizua sipas percaktimeve të Kodit Zgjedhor.

3. Afishimi i materialeve propagandistike.

- Komisioneri miratoi Udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
- Edhe pse udhëzimi u miratua në prag të fushatës zgjedhore, ai u respektua përgjithësisht nga bashkitë dhe subjektet zgjedhore. Gjatë administrimit të denoncimeve, u konstatua se një pjesë e tyre, por edhe objekt i raporteve të monitorimit nga monitoruesit, ishin mbi afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim me udhëzimin.
- 34 bashki sollën në KQZ vendimin për vendafishimet e lejuara të materialeve propagandistike për fushatën zgjedhore. Gjatë monitorimit të faqeve zyrtare të bashkive u konstatua se përgjithësisht u respektua detyrimi për publikimin e vendeve publike brenda territorit të bashkisë ku mund të afishohen material propagandistike. Ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, u morr sanksion administrativ nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për mosdisponimin e një faqeje zyrtare interneti, si rrjedhojë e një denoncimi.

4. Ndjekja e ankimeve ndaj akteve të Komisionerit në KAS.³

Administrata e KQZ-së, në zbatim të detyrave të saj, asiston Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve për çështje që ai shqyrton. U krijua regjistri i kërkesave ankimore. Për çdo kërkesë ankimore bëhet njoftimi i KAS. Hedhja e shortit për përcaktimin e relatorit të çështjes objekt ankimi organizohet nën kujdesin e Sekretarit të Përgjithshëm në seancë publike. Administrata vë në dispozicion të KAS të gjithë dokumentacionin shoqërues të ankimeve dhe ndjek procesin e shqyrtimit administrativ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të sfidave të shumta dhe kohës shumë të ngushtë për të implementuar kërkesat e reja ligjore, synoi transparencën më të lartë qoftë për veprimet e saj administrative/operacionale apo mundësimin dhe realizimin me sukses të mjeteve transparente të imponuara nga ndryshimet e reja ligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi në mënyrë dinamike të gjithë procesin zgjedhor përmes mekanizmave të veçantë për të lehtësuar aksesin e të gjithë aktorëve (partive politike, OJF-ve dhe individëve) në raportimin/ denoncimin e shkeljeve zgjedhore, keqpërdorimet e burimeve publike, financimit të partive politike, nëpërmjet portalit të dedikuar në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, adresës postare zyrtare, aplikacionit në celular (KQZ).

Në total, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi 136 (njëqind e tridhjet e gjashtë) ankime administrative. Për shkak të njejtit objekt apo subjekt është bërë bashkimi i ankimeve. Komisioneri doli me 103 (njëqind e tre) vendime, nga të cilat 8 (tetë) u ankimuan në KAS. Për këto 8 raste, KAS vendosi:

- 3 (tre) raste ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- 1 (një) rast lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- 3 (tre) raste shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe riçeljen e hetimit administrativ për të njëjtën çështje;
- 1 (një) rast mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore.

Të dhëna statistikore:

Pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve janë depozituar në total 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) kërkesa ankimore, nga të cilat:

- 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) janë kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- 9 (nëntë) janë kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor.

³ Rekomandimi 2 i Rezolutës së Kuvendit

Për 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) kërkesat ankimore ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

- Për 21 (njëzet e një) kërkesa ankimore, është lënë në fuqi vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Për 25 (njëzet e pesë) kërkesa ankimore është ndryshuar vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Për 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa ankimore është vendosur shfuqizimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Për 2 (dy) kërkesa ankimore është vendosur pushimi i shqyrtimit;
- Për 8 (tetë) kërkesa ankimore është vendosur morpranimi për shqyrtim.

Tipologjitë e kërkesave ankimore drejtuar KAS, ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

- 8 (tetë) kërkesa ankimore për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:
 - Për 3 (tre) kërkesa, KAS vendosi pranimin e kërkesës ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Për 3 (tre) kërkesa, KAS vendosi shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe riçeljen e hetimit administrativ të plotë nga KSHZ;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.
- 2 (dy) kërkesa ankimore për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021;
 - Për 1 (një) kërkesa, KAS vendosi pranimin e kërkesave ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi rrëzimin e kërkeses ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 1 (një) kërkesë ankimore për logon e subjektit zgjedhor në përmbajtjen e fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi pranimin e kërkesave ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 2 (dy) kërkesa ankimore për caktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këto, KAS vendosi rrëzimin e kërkesave dhe lënien në fuqi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 1 (një) kërkesë ankimore për shqyrtimin dhe zgjidhjen në rrugë administrative të ankesës së Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit;
 - Për këtë, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.

- 2 (dy) kërkesa ankimore për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këto, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 3 (tre) kërkesa ankimore për pamundësinë për të ushtruar të drejtën e votës jashtë shtetit;
 - Për këto, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.

- 7 (shtatë) kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj anëtarëve të KZAZ-ve;
 - Për këto, KAS vendosi pranimin e kërkesave ankimore dhe shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 3 (tre) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Vlorë dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këto KAS vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 2 (dy) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Durrës dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 3 (tre) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Gjirokastrë dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për 2 (dy) kërkesa, KAS vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.

- 1 (një) kërkesë ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Lezhë dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi pushimin e shqyrtimit.

- 2 (dy) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Korçë dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këto KAS vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 1 (një) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Elbasan dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 4 (katër) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Tiranë dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për 3 (tre) kërkesa, KAS vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi pushimin e shqyrtimit.

- 1 (një) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Shkodër dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 3 (tre) kërkesa ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Berat dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;

- Për këto, KAS vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - 1 (një) kërkesë ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të qarkut Fier dhe ku kërkohet pavlefshmëria për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - 1 (një) kërkesë ankimore kundër miratimit të tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit dhe ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - 2 (dy) kërkesa ankimore për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve zgjedhore për miratimin e listave shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi pranimin e kërkesës ankimore dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - 1 (një) kërkesë ankimore për konstatimin e pamjeve filmike të ZAZ-ve për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.
 - 14 (katërbëdhjetë) kërkesa ankimore për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre;
 - Për këto, KAS vendosi pranimin e kërkesave pjesërisht dhe ndryshimin pjesërisht të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - 2 (dy) kërkesa ankimore për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të njoftimit dhe materialeve zgjedhore;
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për 1 (një) kërkesë, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim.
- KAS, për 9 (nëntë) kërkesat ankimore ndaj vendimeve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor;

- 9 (nëntë) kërkesa për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore”,
 - Për këto, KAS ka vendosur pranimin e kërkesave ankimore, shfuqizimin e vendimeve të KZAZ-ve dhe detyrimin e tyre të akreditojnë vëzhguesit e subjekteve ankuese.
(Ndaj tyre nuk është bërë asnjë ankim në Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë)
- Ndaj vendimmarrjes së KAS, janë depozituar 25 (njëzet e pesë) kërkesë padi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, prej të cilave:
 - Për 2 (dy) kërkesa ka vendosur pushimin e çështjes;
 - Për 2 (dy) kërkesa ka vendosur për pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Për 20 (njëzet) kërkesa ka vendosur rrëzimin e padisë;
 - Për 1 (një) kërkesë ka pranuar pjesërisht ankimin dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Tipologjitë e çështjeve të depozituara në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë:


- 1 (një) kërkesë padi për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur pushimin e çështjes dhe dërgimin e kësaj çështje për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.
- 2 (dy) kërkesë padi për miratimin e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021:
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 1 (një) kërkesë padi për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, shfuqizimin e vendimit të KAS dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

- 1 (një) kërkesë padi për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prillit 2021;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës.
- 1 (një) kërkesë padi për regjistrimin e subjektit politik për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur pushimin e çështjes.
- 1 (një) kërkesë padi për caktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës.
- 3 (tre) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Gjirokastrë;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 2 (dy) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Vlorë;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës
- 2 (dy) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Berat;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 2 (dy) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Korçë;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 2 (dy) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Tiranë;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 1 (një) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Durrës;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 1 (një) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Shkodër;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.

- 1 (një) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Fier;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 1 (një) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për qarkun Elbasan;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 1 (një) kërkesë padi ku kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021;
 - Për këtë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.
- 2 (dy) kërkesë padi për mosmarrjen e vendimit për të ushtruar të drejtën e votës jashtë shtetit;
 - Për këto, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palës paditëse.

5. Raportet e Monitorimit të fushatës zgjedhore

Për periudhën Mars 2021 deri më datë 25 Prill 2021 monitoruesit e KQZ-së përpiluan raporte monitorimi (raporte periodike çdo 10 ditë, raporte për shkelje flagrante rast pas rasti si dhe raportin përdundimtar) gjatë gjithë periudhës së para dhe gjatë fushatës, duke evidentuar dhe dokumentuar aktivitetet e partive politike/kandidatëve në 12 qarqet. Raportet u bënë publike në kohë reale në faqen e internetit të KQZ-së. KQZ, gjatë hetimit administrative të denoncimeve angazhoi monitoruesit në terren për verifikimin e tyre. Pas përfundimit të procesit, monitoruesit u pajisën me një çertifikatë vlerësimi për kontributin e dhënë gjatë periudhës zgjedhore.



Nga praktika u konstatua se numri i monitoruesve ishte relativisht i vogël në raport me zonat për të cilat ata duhet të raportojnë, e cila solli probleme dhe vonesa në raportim. Duke qenë se një monitorues duhet të mbulonte zona, të cilat ishin disa kilometra larg nga njëra tjetra, e kishte të pamundur të monitoronte aktivitetet që mund të zhvilloheshin në të njëjtën kohë në dy zona të ndryshme.

6. Kontrolli i financimit të fushatës zgjedhore

Menjëherë pas miratimit të amendimeve ligjore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u angazhua për zbatimin e parashikimeve të Kodit Zgjedhor duke nxjerrë një numër të konsiderueshëm aktesh nënligjore në mbështetje të tij. Kodi Zgjedhor, ligji për partitë politike dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, përcaktojnë instrumentet e financimit, kontrollit dhe transparencës së subjekteve politike.

7. Shpërndarja e fondeve paradhënie nga buxheti i shtetit për zgjedhjet e datës 25 prill 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi sasinë e fondit që do t'u shpërndahej si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Vetëm 10 (dhjetë) parti politike përfituan fonde paradhënie nga të gjitha ato që morën pjesë në zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por përpara shpërndarjes së fondeve, partitë përfituese (kryetar ose person i autorizuar) nënshkruan aktmarrëveshjen, në të cilën përcaktohet se partia politike pranon fondin e dhënë, se do ta përdorë atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara, pranon auditimit e shpenzimit të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektojë të gjitha ndalimet që përcaktohen në Kodin Zgjedhor për ta.

Çelja e fondeve nga Ministria e Financave u bë brenda afatit të domosdoshëm për kryerjen e të gjitha procedurave prokuruese.

- **Fondet e marra nga buxheti i shtetit për partitë politike**

Me vendimin nr. 172, datë 23.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u vendos shpërndarja si paradhënie, e fondeve të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, si me poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i partisë politike</i>	<i>Fondi i përfituar/lekë</i>
1	Partia Demokratike (PD)	33,318,149
2	Partia Republikane (PR)	3,926,232
3	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	1,434,012
4	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	55,826,750

5	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	18,975,182
6	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	5,552,885
7	Partia Fryma e Re Demokratike (FRD)	2,188,832
8	Partai Demokristiane (PDK)	1,479,742
9	Partia Social Demokrate (PSD)	1,629,360
10	Partia Bindja Demokratike	1,485,550
TOTAL		125,816,694

Seksioni XI: Media gjatë fushatës zgjedhore

1. Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore

Kapitulli VI i Kodit Zgjedhor rregullon në mënyrë të detajuar pasqyrimin e fushatës në Radio-Televizionin Publik Shqiptar dhe median audio-vizive private. Nuk ka asnjë dispozitë lidhur me median e printuar dhe atë online.

Sa i përket veprimtarisë së medias në fushatë zgjedhore, Kodi Zgjedhor ka parashikuar monitorimin e medias audiovizive për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhje. Monitorimi i tyre bëhet nëse ato e respektojnë hapësirën kohore që duhet të vënë në dispozicion të tyre, nëse materialet e transmetuara prej tyre janë në përputhje me dispozitat ligjore (të jenë të identifikuar qartë, të jenë në përputhje me kriteret profesionale të pasqyrimin të lajmit/aktivitetit/veprimtarisë, dhe nëse e respektojnë ndalimin për të bërë propagandë/komente dhe qëndrime personale gjatë raportimit të lajmeve).

Kodi parashikon kohë falas në dispozicion të subjekteve zgjedhore në Tv Publik, por jo në ato private. Proporcioni i kohës që vihet në dispozicion të subjekteve është e llogaritur në bazë të pasjes ose jo të mandateve në Kuvendin e Shqipërisë, si edhe në bazë të numrit të mandateve në Kuvend për subjektet që kanë mandate.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor me ligjin 101/2020 adresuan rekomandimet e OSBE/ODIHR lidhur me nenin 84 pika 1 e KZ, i cilësuar si neni i “kasetave”. U shtua shkronja d në pikën 2 të këtij neni “Media audiovizive përgatit lajmet në liri të plotë editoriale. Kur për shkaqe objektive media nuk është në gjendje të ndjekë veprimtari të veçanta zgjedhore, ajo lejohet të shfrytëzojë dhe përzgjedhë pamje filmike nga regjistrimet e plota të servitura nga subjektet zgjedhore, me kushtin që ta shoqërojë lajmin me shënimin “materiali filmik servitur nga subjekti...”.

Gjithsesi, në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR sugjerohet që neni 84 pika 1 të rishikohet dhe të mos lejohen filmimet e pararegjistruara.

Në respektim të Kodit Zgjedhor, pas regjistrimit të subjekteve zgjedhore, KQZ përcaktoi minutazhin falas që Televizioni Publik Shqiptar duhet të vendoste në dispozicion të subjekteve. Vendimi i KQZ-së i'u vu në dispozicion TVSH-së, i cili hodhi shortin për renditjen e subjekteve. Rezultatet e shortit u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së.

Gjatë pasqyrimin të fushatës zgjedhore media pati vështirësi në përlllogaritjen e minutazhit të subjekteve zgjedhore përfshirë ndarjen e kohës mes koalicioneve. OSHMA-të kishin paqartësi lidhur edhe në lidhje me kohën falas që duhet tu ofrojnë subjekteve dhe llogaritja e saj si shpenzim i zbritshëm tatimor.

Kodi Zgjedhor në nenin 84 pika 5 ka përcaktuar detyrimin e Medias Audio-vizive detyrimin për të depozituar pranë KQZ-së tarifën zyrtare të fushatës zgjedhore me qëllim trajtimin e barabartë për subjektet zgjedhore në pasqyrimin fushatës zgjedhore. Po ashtu, dorëzimi në KQZ i tarifave zyrtare për transmetimin e materialeve promociionale/reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore nga mediat audiovizive, shërben si indikator për vlerësimin e shpenzimeve të kryera nga partitë politike/kandidatët gjatë fushatës zgjedhore. Afati i fundit për dorëzimin e tyre është 5 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore.

Këtë detyrim e përmbushën 13 televizione dhe një radio (48 Tv dhe 60 radio).

2. Raportet e monitorimit të medias audio dhe vizive

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor me ligjin 101/2020 sollën ndryshime sa i përket monitorimit të medias audiovizive. Kodi Zgjedhor përcaktoi se monitorimi i medias gjatë fushatës zgjedhore do të bëhet nga Autoriteti i Medias Audio-vizive (AMA) sipas metodologjisë së miratuar nga KQZ. Metodologjia përcaktoi procedura dhe teknika të posaçme që ndjek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore 30 ditore nga Ofruesit e Shërbimeve Mediatike audio dhe/ose audiovizive (OSHMA).

KQZ bazuar edhe në manualin e monitorimit të medias së OSBE/ODIHR hartoi dhe miratoi metodologjinë e monitorimit të medias, me Vendimin nr.2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator. Kjo metodologji solli disa risi sa i përket monitorimit cilësor si:

1. Gjuha e urrejtjes;
2. Raporti gjinor i mbulimit mediatik të kandidatëve;
3. Koha/hapësira që u jepet fjalimeve të drejtëpërdrejta;
4. Aktorit politik që i jepet hapësirë mediatike dhe renditja e tyre;
5. Reklamën politike;

MMM përcaktoi se raportet ditore të përgatitura nga AMA dhe paraqiten në KQZ do të përmbanin të dhëna sasiore, ndërsa raportet javore do të përmbanin të dhëna cilësore.

AMA 29 raporte ditore, nga data 26.03.2021 deri në datën 23.04.2021, dhe 4 raporte javore. Data 24 prill ishte heshtje zgjedhore.

Heshtja zgjedhore e zgjedhjeve të 25 prillit 2021, sipas raportimit të AMA, u thye nga dy kanale të Televizionit Publik Shqiptar (RTSH 2 dhe RTSH Kukësi). KQZ vendosi sanksione administrative për thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Gjatë monitorimit të medias në fushatë zgjedhore, AMA në raportet e saj ka konstatuar se ka patur reklama politike të transmetuara nga OSHMA-të të pa identifikuar qartë se kujt subjekti i përkasnin. Gjithashtu, ka konstatuar se ka patur raste se minutazhi i reklamave politike ka tejkalar minutazhin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

Vitet e fundit dhe veçanërisht fushata zgjedhore e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021 për shkak edhe të kushteve të pandemisë Covid 19, u zhvillua në median online (elektronike dhe rrjetet sociale). Subjektet zgjedhore dhe kandidatët preferuan shpalosjen e materialeve të tyre propagandistike dhe reklamat politike në platformat e rrjeteve sociale dhe mediat online, pasi edhe audiencia në këto media është më e madhe.

Mungesa e rregullave dhe e monitorimit të medias online/sociale ka bërë që fushata e zhvilluar në to, të jetë e ashpër dhe me informacione të dyshimta me burime të pakonfirmuara. Kjo ka sjellë keqinformim dhe shpërndarje të informacioneve të rreme për publikun.

Mungesa e monitorimit të medias online dhe asaj të printuar, bën të pamundur mosverifikimin e shpenzimeve të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në këto media. Gjatë kontrollit financiar të subjekteve zgjedhore për shpenzimet e fushatës, KQZ mund të konstatojë vetëm atë që vetë subjekti/kandidati ka deklaruar pa patur mundësinë për ta verifikuar/ballafaquar me të dhënat e monitorimit të këtyre mediave.

Sugjerohet rishikimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe përfshirjen e monitorimit të medias online/sociale me qëllim krijimin e kushteve të barabarta për subjektet që garojnë, veçanërisht garantimin e të drejtës së qytetarëve për të krijuar bindjen e tyre mbi informacione të sakta por edhe për shkak se subjektet zgjedhore shpenzojnë shuma të mëdha parasha për fushatën në këto media.

Kreu II: Dita e Zgjedhjeve dhe rezultati

1. Hapja e QV

Administrata e komisioneve të qendrave të votimit ka qene e pranishme në 5199 QV në mbare vendin në orarin e caktuar. Në ora 07:00, nuk është raportuar mungesa e komisionerëve apo mungesa e bazës materiale zgjedhore. Edhe një QV në Elbasan u pretendua në mëngjes mungesa e fletëve të votimit por më pas raportuan gabimin e bërë prej tyre në konstatimin e bërë duke vijuar procedurat normale të votimit.

Ditën e zgjedhjeve 144 QV funksionuan pa Pajisjen Elektronike të Identifikimit (PEI). Dhe rreth 4% e QV raportuan vështirësi në momentin e fillimit të procedurave nëpërmjet PEI/ apo gjatë procesit të votimit. 4% e QV filluan votimin me vonesë deri në 30 minuta për shkak të PEI (vonesë e operatorëve, vëzhgimi në përdorimin e pajisjes). Në 3 QV u kërkua ndërhyrja e policisë për

shkak të të grumbullimeve (KZAZ Nr. 9 për 2 QV dhe KZAZ Nr. 33 për 1 QV), ndërsa në KZAZ Nr. 41 u raportua ndërprerje e energjisë elektrike në 2 QV.

Zgjedhjet u zhvilluan në një ambient të qetë ndonëse ditën e zgjedhjeve në aplikacionin KQZ pati raportime për fotografim vote, blerje votash. Pjesëmarrja ishte konstante gjatë gjithë ditës së votimit. KQZ inspektoi denoncimet për shitblerje të votave referuar raportimeve të monitoruesve sikundër edhe QV të caktuara.

Në qendrat e vizituara të votimit, procedurat përgjithësisht u respektuan, por përdorimi i listës së zgjedhësve nuk ishte konsistente në të gjitha QV. Udhëzimi i KQZ për përdorimin në çdo rast të listës së zgjedhësve (pa nënshkrimin e zgjedhësve) nuk gjeti zbatim në të gjitha QV duke vërejtur disa KQV të cilat nuk përdornin fare atë dhe disa QV aplikonin listat e zgjedhësve përkrah PEI.

Masat parandaluese të COVID-19 nuk u zbatuan mirë dhe distancimi social nuk u respektua gjithmonë, sidomos në qendrat me një numër të madh njerëzish që u vëzhguan. Fshehtësia e votës u respektua përgjithësisht në qendrat e vizituara të votimit.

Rreth 4 për qind e qendrave të votimit u hapën me vonesë kryesisht për shkak të çështjeve që kishin të bënin me vënien në punë të pajisjeve të identifikimit elektronik. Në rreth 200 apo 4 për qind të qendrave të votimit, ose për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve të identifikimit elektronik ose për shkak të mungesës së operatorëve teknikë, zgjedhësit u regjistruan duke përdorur listat fizike të zgjedhësve.

Për këto zgjedhje, çdo qendër votimi ishte e pajisur me kamera. Shumica e qendrave të vëzhguara të votimit nuk ishin pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara. Në KZAZ 40 ku u zhvillua pilotimi i votimit dhe numërimit elektronik shumë zgjedhës në moshë madhore kërkonin asistencë në procesin e votimit.

Gjatë ditës së zgjedhjeve raportimi për pjesëmarrjen e zgjedhësve ndeshi në vështirësi teknike për shkak të mos ndërlidhjes së operatorëve me aplikacionin KQZ.

Linjat e ndihmës dhe koordinimi i informacionit

KQZ në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 aplikoi për herë të parë në nivel kombëtar linjat e ndihmës për komisioneret e QV me sistem interaktiv. Në dispozicion të komisionerëve u vendosën në dispozicion të publikut dhe komisionerëve 1 linjë numër telefoni helpdesk, 14 numra celulari për komunikimin me KZAZ dhe të gjitha QV për çdo qark me Whatsapp si dhe aplikacioni KQZ. Administrata e KQZ shpërndau gjithë direktivat, udhëzuesit dhe tutorialet në çdo numër telefoni për anëtar i KQV/ KZAZ-ve duke lehtësuar shpërndarjen dhe marrjen e informacionit në mënyrë dinamike nga administrata zgjedhore.

Një ekip prej 16 specialistësh të përkohshëm të trajnuar paraprakisht për procedurat e votimit, PEI dhe problematikat e hasura ndër vite, nën asistencën e administratës së KQZ-së ndoqi në dinamikë ecurinë e procesit të votimit duke përpunuar me sukses rreth 5700 telefonata, dhe një numër tejet të konsiderueshëm të mesazheve në Whatsapp.

Numri i QV të raportuara që filluan ose vijuan manualisht procedurën e votimit ishte rreth 167 QV.

Aplikacioni KQZ që u vendos në dispozicion të komisionerëve siguroi një shpërndarje adekuate të njohurive dhe informacionit të domosdoshëm për administratën zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, 30 QV mundësuan përdorimin dhe raportimin e aplikacionit, ndërsa u raportuan edhe 12 problematika të ndryshme në ditën e zgjedhjeve.

Vendosja e mjeteve të komunikimit me KZAZ/ KQV (aplikacioni KQZ/Whatsapp) duke synuar numrin më të madh të mundshëm të komisionerëve për informimin e komisionerëve në lidhje me procedurat e votimit, shpërndarjen e tutorialeve për pajisjet e teknologjisë në zgjedhje, reduktoi në mënyrë të konsiderueshme problematikën që mund të sillte një proces me risi dhe sfida të shumta.

2. Procedurat e numërimit dhe shpalljes së rezultatit

2.1. Numërimi

Procesi i numërimit ndryshe nga vitet e tjera pati një vëmendje të posaçme me qëllim zbatimin e kërkesës së Kodit për shpalljen paraprake të rezultatit të zgjedhjeve brenda 48 orëve.

Procesi i numërimit në të gjitha KZAZ filloi normalisht dhe pa problem deri në një moment kur disa KZAZ raportuan për ndërprerje të procesit të numërimit për shkak të lodhjes, fenomen i evidentuar në çdo proces zgjedhor.

KQZ monitoroi në vijimësi dhe me konsistencë 24/24 performancën e KZAZ-ve duke marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe insistues i KZAZ-ve gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave, nxjerrja e udhëzuesve që normonin punën e tyre solli minimizimin e influencave nga faktorë të jashtëm në vonimin e shpalljes së rezultatit paraprak të zgjedhjeve.

Vendosja e sanksioneve dhe rritja e kërkesës së llogaridhënies ndaj KZAZ dhe rrjedhimisht edhe ndaj GNV bënë të mundur që rezultati paraprak i zgjedhjeve të deklarohet në orët e para të mëngjesit të datës 30.4.2021.

2.2. Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ në KQZ

Pas mbylljes së procesit zgjedhor, secila KZAZ vijon me dorëzimin e dokumentacionit në KQZ. Dorëzimi i materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor u krye nga të gjitha KZAZ-të dhe u administrua në KQZ.

Në dorëzimin e dokumentacionit zgjedhor, një pjesë e madhe e KZAZ-ve modelet e vendimeve dhe të emërimeve të anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, nuk i sjellin të plota ose përfundimtare ,

çka përbën problem në hedhjen e të dhënave për krijimin e bazës së të dhënave të anëtarësisë për KQV-të dhe GNV-të.

2.3. Informim i përqindjes së votimit periodikisht nëpërmjet teknologjisë

Informimi mbi përqindjen e votimit periodikisht çdo një orë gjatë ditës së votimit nëpërmjet aplikacionit “KQZ”. Informimi mbi përqindjen e votimit periodikisht garanton transparencën.

Duke qenë se ky projekt u zbatua për herë të parë dhe koha e implementimit ishte tepër e shkurtër, pati paqartësi të komisionerëve dhe operatorëve për shfrytëzimin me efikasitet të aplikacionit “KQZ”.

2.4. PEVN (Pajisja Elektronike e Votimit & Numërimit)

Gjatë zgjedhjeve për Kuvend 25 Prill 2021 në njësinë bashkiake Nr. 10, ZAZ 40 u votua duke përdorur “Pajisjen Elektronike të Votim Numërimit, PEVN”. Procesi i votimit ishte tërësisht elektronik dhe projekti ishte projekt pilotimi.

Procesi i votimit në datën 25 Prill 2021 u krye normalisht dhe në të 32 QV e ZAZ 40 funksionoi votimi elektronik ku zgjedhësit mundën të votonin të gjithë duke përdorur vetëm pajisjet PEVN. Procesi i votimit rezultoi i thjeshtë dhe pa probleme teknike duke mundësuar që zgjedhësit të mund të shprehnin zgjedhjen e tyre në fshehtësi të plotë duke ruajtur anonimitetin.

Në të pestë vendvotimet në korridor u instaluan pajisje demo për të edukuar zgjedhësit para se të procedonin në qendrën e votimit. Personat të cilët kryen edukimin e zgjedhësve në pajisjet demo në këto pesë vendvotime vërejtën se zgjedhësit e moshuar e kishin më të vështirë për ta kryer procesin e votimit.

Nga analiza e kryer për projektin PEVN në njësinë bashkiake Nr. 10, ZAZ 40 u vu re se projekti ishte i suksesshëm, i besueshëm dhe i shpejtë. Këtë gjë e dëshmon edhe fakti se për këtë ZAZ nuk pati asnjë ankesë nga asnjë subjekt politik si për procesin e votimit elektronik në datën 25 Prill 2021 po ashtu edhe pasi u publikuan rezultatet paraprake për subjektet politike dhe kandidatëve për deputet.

2.5. Koordinimi në terren

KQZ angazhoi specialistët rajonal për verifikimin, koordinimin e informacionit në terren duke u mbështetur në praktikën e deritanishme të inspektorëve rajonal, ndonëse kjo strukturë u amendua nga ndryshimet ligjore.

KQZ rekrutoi 27 specialistë rajonal të cilët u angazhuan për rreth 908 raste koordinimi. Peshën më të madhe të aktivitetit të tyre e kishin organizimi i trajnimeve për operatorët PEI me 258 raste, ndjekja e dorëzimit dhe e problematikave lidhur me Bazën Materiale Zgjedhore për rreth 214 raste si dhe janë angazhuar për hetimin e problematikave të ndryshme ditën e zgjedhjeve në 231 raste, pa përmendur këtu rreth 172 raste angazhimi për inspektimin e QV/ VNV, trajnimit të komisionerëve, apo ndjekjen e procesit të numërimit të votave.

Specialistet rajonal bashkërenduan informacionin me KZAZ-të dhe bashkitë për vendodhjet e QV, asistuan në organizimin e trajnimeve të operatorëve PEI, monitoruan trajnimin e KQV/GN, monitoruan procesin zgjedhor dhe koordinuan aktivitetet për marrjen në dorëzim të BMZ.

3. Marrja në dorëzim e kutive të numëruara dhe materialeve zgjedhore

Pas numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit, kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, fillojnë të dorëzohen nga ana e KZAZ-ve. SMMZ hartoi dhe për këtë proces një databazë të mirëcaktuar për mënyrën e marrjes në dorëzim të këtyre materialeve, pa shkaktuar pritje me orë dhe lodhje për KZAZ-të, të cilat dorëzonin bazën materiale zgjedhore. Çdo gjë u krye mjaft shpejt dhe pa ngarkesa për anëtarët e KZAZ-së të cilët i dorëzonin.

Kutitë e fundit të votimit dhe të materialeve zgjedhor të dorëzuara në magazinat e Llundrës ishin në datë 02.05.2021.

Në dorëzim nga KQZ merren vetëm kutitë e votimit, kutitë e materialeve zgjedhore, elementët ndarës. Kurse pjesa tjetër e dokumentacionit dorëzohet në zyrën e protokollit të KQZ-së.

Dhe nga ky proces nuk patëm asnjë problematikë. Më pas u vazhdua me sistemimin e këtyre materialeve ana e personelit mbështetës.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi hapjen e kutive të votimit për qarkun Berat dhe Durrës, për arsye të kërkesave ankimore të ardhura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ky proces u përgatit nga SMMZ për materialet logjistike të nevojshme, për sjelljen e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, hapjen, numërimin, mbylljen me kodet e sigurisë dhe më pas dërgimin prapë të kutive të votimit në magazinat e Llundrës.

Nr. kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore për qarkun Berat 114+114

Nr. kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore për qarkun Durrës 108+108

4. Rezultati i zgjedhjeve

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve u miratua dhe u shpall nga Komisioni Rregullator në datën 13.07.2021, pas përfundimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor. Komisioni Rregullator zhvilloi mbledhjen në seancë publike me pjesëmarrjen e grupeve të interesit. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë u publikua në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

Kreu III: Periudha paszgjedhjeve


Seksioni 1. Analiza e realizimit buxhetor

1.1. Realizimi i buxhetit të zgjedhjeve

Amortizimi i Fondit total të Buxhetit të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021 deri në datën 15 Tetor 2021 në Lekë:

Nr	ZERAT E BUXHETIT	Miratuar	Shpenzuar
I	PAGAT	300,000,000	272,740,690
1	Pagat personelit te perkohshem ne KQZ	80,000,000	77,289,748
2	Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, ZR, trajnuesve te KZZ,KQV,GNV	220,000,000	204,376,250
II	MALLRA & SHERBIME	631,000,000	608,263,650
III	INVESTIME	2,946,000,000	2,916,129,079
1	Kamera per sistemin video-monitorimin ne qendrat e votimit	394,000,000	371,766,936
2	Projekti pilot i votim numerimit elektronik ne KZAZ nr.40	125,813,257	119,087,712
3	Projekti i identifikimi elektronik i zgjedhësve	2,426,186,743	2,425,274,431
	TOTALI	3,877,000,000	3,805,550,647

Paraqitja grafike e realizimit të Buxhetit të Zgjedhjeve sipas Shpenzimeve Korrente dhe Kapitale deri ne datën 15 Tetor 2021



Realizimi i fondeve të miratuara për përgatitjen dhe realizimin e zgjedhjeve, u bë në përputhje të plotë me gjithë legjislacionin në fuqi për pagat dhe sigurimet, për procedurat tatimore, për prokurimin publik etj.

1.2. Fondi për Paga, Sigurime dhe Shpërblime

Me miratimin e strukturës së personelit të përkohshëm u kryen procedurat si edhe u përgatitën listapagesat për afersisht 300 punonjës të përkohshëm. Nëpërmjet sistemit të tatimeve u bë regjistrimi i të gjitha punësimeve të reja, si edhe çregjistrimi i tyre në momentin e mbarimit të kontratës.

Në total fondet për pagesën e personelit të përkohshëm si edhe shpërblimet (KZAZ, KQV, GNV, trajnuesit, etj) u realizuan në masën 91%. Nga 300 milionë lekë të planifikuara në zërin paga dhe sigurime shoqërore, u realizuan 273 milionë lekë. Diferenca/kursimi prej 27 milionë lekësh ka lidhje kryesisht me numrin e qendrave të votimit, ishin parashikuar 5500 qendra votimi, u ngritën realisht 5199 qendra votimi, (25000 lekë/kosto për QV*300QV=7.5milionë lekë), pagesa e trajnuesve pati diferenca gjithashtu pasi koha e trajnimit ishte shumë e ngushtë me ditën e zgjedhjeve dhe nuk u plotësuan të gjitha ditët e parashikuara për trajnim (6 milionë Lekë) si edhe me faktin që jo i gjithë personeli i punësuar kishte vjetërsi pune maksimale. (7000 lekë/muaj * 225 persona *4 muaj=6.3milionë lekë).

1.3. Fondet e Administruara nga KZAZ

Një pjesë të konsiderueshme të buxhetit që i akordohet KQZ-së për realizimin e procesit zgjedhor, pothuajse 1/3 e tij, KQZ-ja nuk e menaxhon vetë por nëpërmjet Ministrisë së Financave ajo e transferon këtë fond nëpër njësitë vendore ku operojnë Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Kodi Zgjedhor, Neni 33, Pika d.


KQZ-ja bën llogaritjet për shumat përkatëse që do transferohen në çdo njësi vendore dhe më pas janë njësitë vendore kundrejt procedurave të tyre që kryejnë pagesën ndaj përfituesve. Njësitë vendore duhet të kryejnë pagesën kundrejt dokumentacionit të paraqitur nga komisionerët e ZAZ-ve në zyrat e njërive vendore (borderotë për shpërblimet e komisionerëve, faturat për transportin e BM si dhe kontratat e qerave për ambjentet private).

KQZ-ja nuk është përgjegjëse për mënyrën e shpërndarjes së këtyre fondeve drejt përfituesve finalë por ajo udhëzon njësitë vendore për mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve.

Procedura e transferimit të fondeve realizohet në tre faza, sipas llojit të shpenzimeve që mbulohen me këto fonde. Dy faza kryhen përpara datës së zgjedhjeve dhe faza e tretë është pas përfundimit të procesit të zgjedhjeve si më poshtë:

- Transferimi për shpenzime transporti të bazës materiale nga KZAZ në QV dhe anasjelltas,

- Transferimi për shpërblimin e komisionerëve të KZAZ, KQV, GNV si edhe shpenzime qeraje,
- Transferimi për pagesën e QV në ambiente private.



Për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, u transferuan pranë njësive vendore, fondet si më poshtë:

Shpenzime për transportin e bazës materiale KZAZ-QV-KZAZ, KZAZ-KQZ,	13,604,000 lekë
Shpenzime për shpërblimin e komisionerëve të KZAZ, KQV, GNV,	195,551,000 lekë
Shpenzime për QV me qera,	4,656,000 lekë
Shpenzime për VNV me qera,	100,000 lekë
<u>Në total</u>	<u>213,911,000 lekë</u>

Problematika në lidhje me realizimin e fondeve të ky zë i shpenzimeve, e cila ka të bëjë kryesisht më anën teknike, si më poshtë:

Problematika që shoqërojnë administrimin e fondeve nga KZAZ-të, të cilat edhe pse kanë qenë prezentë në çdo proces zgjedhor akoma nuk kanë gjetur zgjidhje janë si më poshtë:

- Një problem kryesor është lirimi dhe emërimi i komisionerëve të ZAZ-ve. Komisionerët aktivizohen në ZAZ për një periudhë 3 mujore dhe mbas përfundimit të procesit zgjedhor ata marrin shpërblimin e përcaktuar me Vendim të KQZ-së. Në të shumtën e rasteve komisionerët lirohen nga pozicioni që kanë, pak ditë përpara datës së zgjedhjeve, pasi kanë punuar për një kohë të konsiderueshme në KZAZ dhe në vend të tyre emërohen kandidatë të tjerë. Në momentin e pagesës së tyre (listëpagesat përgatiten nga sekretari i KZAZ-së, firmosën nga kryetari dhe zv/kryetari) në listëpagesë rezulton emri i personit që është emëruar i fundit nga KQZ.
- Problematikë është hasur dhe në fondet për transportin e bazës materiale KZAZ-QV-KZAZ, KZAZ-KQZ. Referuar nenit 33, gërma d, të Kodit Zgjedhor “KZAZ *administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja*”, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e ka patur gjithmonë të vështirë llogaritjen e këtyre fondeve pasi nuk ka një tarifë transporti të miratuar dhe nuk

ka një hartë miratuar nga organet përkatëse të distancave kilometrike midis vendodhjes së ZAZ-ve dhe QV-ve. Për këtë arsye ka patur dhe ankime nga ana e Komisionerëve të ZAZ-ve. Gjithashu edhe nga ana e njësive vendore ka patur probleme me prokurimin e fondeve në emër të ZAZ-ve, pasi ZAZ-të operojnë si një komision Ad-Hoc dhe nuk janë subjekt tatimor me numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) që të administrojnë dhe prokurojnë fonde buxhetore.

1.4. Fondi për mallra dhe shërbime zgjedhore

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për mallra dhe shërbime zgjedhore, 631 milionë lekë, u përdorën për blerjen e bazës materiale zgjedhore:

- Fletë votimi & shabllonë të posaçëm për votuesit e verbër,
- Kode sigurie,
- Bojë timbruese,
- Vula për KZAZ-të dhe KQV-të,
- Dhoma të fshehta,
- Kuti kartoni për transportin e bazës materiale zgjedhore,
- Shtypshkrime,
- Kancelari,
- Materiale promocionale (postera, fletëpalosje, kapele, bluza, stilolapsa etj)

1.5. Për shërbime të ndryshme, në funksion të zgjedhjeve

- Shërbim për implementimin dhe menaxhimin e sistemit të kamerave,
- Transportin e bazës materiale zgjedhore,
- Udhëtime dhe dieta të administratës,
- Njoftime të ndryshme në media të lidhura me procesin zgjedhor,
- Ambjente me qera për VNV, QV
- Mjete transporti me qera, si p.sh autobus për transportin e punëtorëve KQZ-Lundër,
- Shërbime për programet aplikativë të informacionit parazgjedhor,
- Shërbim për përditësim dhe asistencë për programet aplikativë për rezultatet,
- Shërbim për përditësimin dhe printimin e hartave,
- Shërbim për siguri fizikë me roje private,
- Shërbim të ndryshme,
- Transmetimi i fushatës edukuese, informuese, sensibilizuese në media,

Fondet për mallra dhe shërbime zgjedhore u realizuan në masën 96 %. Nga 631 milionë lekë të planifikuara në zërin mallra dhe shërbime zgjedhore, janë të realizuar rreth 609 milionë lekë.

Në buxhetin e realizuar vihet re një tejkalim i fondit të parashikuar në zërin Mallra-Materiale (shtypshkrime) e cila ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe risive në fushën

e teknologjisë dhe informacionit që u përdorën për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Gjithë procesi i sigurimit të bazës materiale dhe shërbimeve zgjedhore, nuk pati ndonjë problematikë për t'u shënuar. Baza materiale zgjedhore u sigurua në kohë, mallrat u lëvruan sipas afateve të përcaktuara në kontratat përkatëse, u bënë hyrje në magazinë, u kolauduan dhe u paguan brenda afateve të parashikuara.

Një nga problematikat e hasura ka qenë modaliteti i pagesave për operatorët që morën pjesë në zgjedhje. Termat e pagesave në këtë rast në veçanti, por në përgjithësi në të gjitha kontratat, kanë hapësisra për t'u përmirësuar.

Kjo arrihet duke përcaktuar saktë protokollin e pagesave të përcaktuar në udhëzimin Nr.9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", dhe në të gjitha udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave si dhe duke aplikuar teknologjinë për monitorimin, miratimin konfrom termave të kontratave për të gjitha produktet: shërbime, mallra, apo investime.

Seksioni II: Administrimi dhe arkivimi i dokumentacionit

Në zbatim të Kodit Zgjedhor për afatet e administrimit të dokumentacionit zgjedhor i sjellë nga partitë politike dhe KZAZ-të, është bërë dorëzimi brenda afateve në drejtoritë përkatëse (DJDZ dhe DADSIT)

Gjatë këtij procesi u administrua:

1. dokumentacioni për regjistrimin e partive politike;
 2. dokumentacioni i listave të kandidatëve për deputet;
 3. dokumentacioni për kandidatët e pavarur.
 4. formular vetëdeklarimi për kandidatët deputet/kandidat për këshilltar bashkiak në regjistrin përkatës.
- Administrimi i dokumentacionit zgjedhor nga KZAZ në KQZ

Pas datës 25 prill u morën në dorëzim dokumentacioni me procesverbalet përkatëse për 92 KZAZ-të:

1. vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse për subjektet edhe kandidatët;
2. tabela përmbledhëse e rezultateve për subjektet dhe për kandidatët;
3. tabelat e QV-ve për çdo subjekt në zgjedhje;
4. tabelat e QV-ve për çdo kandidat;
5. libër protokolli;
6. procesverbal konstatimi;
7. regjistër i korrespondencës;
8. regjistër i vendimeve;

9. vendimet e emërimit të anëtarëve/kryetar/sekretar dhe grupeve të numërimit të votave.

Arkiva

Zyra e Arkivës në fillim të vitit 2021, ka marrë nga zyra e Protokollit dokumentacionin administrativ të vitit 2020, ku është bërë përpunimi, numërtimi, plotësimi i dokumentacionit administrativ sipas subjektit të shkresave, plotësimi i inventarit për çdo drejtori dhe skanimi i tyre. Dokumentacionit i është bërë edhe ndarja me ruajtje të përhershme dhe të përkohshme, sipas normave tekniko-shkencore, ligji për Arkivat në Republikën e Shqipërisë. Në total për dokumentacionin për ruajtje të përhershme janë hapur 378 dosje dhe dokumentacioni me ruajtje të përkohshme janë hapur 325 dosje.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 janë sistemuar, numërtuar dhe skanuar; 450 vendime, 15 udhëzime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve 21 vendime të Komisionit Rregullator, 111 vendime të KAS dhe inventari 298 urdhrave.

- inventari, numërtimi dhe skanimi për 326 kontratave të punonjësve me kohë jo të plotë pune, të ndarë sipas drejtorive, kontratat e trajnuesve; 53 kontrata për KZAZ-të, 236 kontrata për KQV-të, 75 kontrata për GNV-të dhe 56 kontrata për PEI. (inventarizuar, numërtuar dhe skanuar).

- inventari, numërtimi dhe skanimi i kontratave për kohë transmetimi me 42 televizione.

- hapjen e dosjeve të punonjësve për pranimin në shërbimin civil me kohë të plotë pune.

Dokumentacioni zgjedhor;

Zyra e Arkivit ka arkivuar dokumentacionin zgjedhor të përdorur për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021, i cili është përpunuar sipas rregullave tekniko-shkencore ku përfshihen; 156 lista shumë-emërore të kandidatëve për deputet për 12 subjektet zgjedhore për çdo qark, sistemuar, plotësuar, numërtuar dhe skanuar.

Është numërtuar dhe skanuar dokumentacioni i sjellë nga KZAZ-të pas përfundimit të procesit zgjedhor.

- 91 tabelat e rezultateve për subjekte; (KZAZ nr.7, sekuestruar nga prokuroria)

- 1156 tabelave të rezultateve të kandidatëve për deputet;

- 89 vendimet për emërimin/lirimin e anëtarëve/kryetarëve/sekretarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit, grupeve të numërimit të votave. I gjithë dokumentacioni zgjedhor është i skanuar.

Seksioni III: Përcaktimi i vlerës në para' të një vote & kompensimi financiar paszgjedhor

Komisioneri përcaktoi vlerën në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ky vendim shërben për përlogaritjen e shumës që do t'u ndahet subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme. U vendos që vlera në para' e një votë të vlefshme është 85 lekë.

Gjithashtu, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi mosshpërndarjen e kompensimit financiar paszgjedhor pasi asnjë nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, të cilat nuk kishin përfituar fonde parashenie, nuk morën më shumë se 1% të votave.

Raportet financiare të subjekteve zgjedhore

Më datë 14.04.2021 Komisioni Rregullator miratoi Vendimi nr. 18, “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë” si dhe Vendimi nr. 13 datë 06.04.2021 “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”;

Referuar nenit 92/3, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet zgjedhore kanë detyrimin të depozitojnë raportet financiare për fushatën zgjedhore brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Vendimet e miratuara parashikojnë afatet e dorëzimit, formatet e standartizuara si dhe mënyrën se si do të plotësoheshin këto formate.

Pjesë e deklaramit janë edhe kandidatët e subjekteve zgjedhore, si edhe kandidatët e pavarur. Përfshirja e kandidatëve në deklaramit, ka sjellë rritje të shtuar të transparencës sa i përket zhvillimit të fushatave në vendin tonë, pasi janë edhe kandidatët ata të cilët përfitojnë donacione dhe dhurime për fushatën zgjedhore. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë dorëzuar 32 (tridhjetë e një) raporte financiare për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021, nga 32 (tridhjetë e dy) raporte në total. Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, dorëzimi i raporteve financiare të fushatës zgjedhore u shty deri me datë 23.09.2021. Brenda afatit të përcaktuar janë dorëzuar 29 raporte financiare.

Të gjitha raportet e dorëzuara janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

Subjektet zgjedhore nuk respektojnë afatin e dorëzimit të raporteve financiare të fushatës zgjedhore, duke sjellë shtyrje të afatit të dorëzimit si dhe pengesa në procedurat e mëtejshme që ndërmerr DKFAB pas depozitimit.

Pjesa më e madhe e subjekteve zgjedhore nuk kanë dorëzuar në format elektronik raportet financiare të kandidatëve.

Raportet e ekspertëve kontabël të licensuar (audites ligjor).

Më datë 21.04.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Udhëzimin nr. 10 “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”. Në këtë udhëzim janë përcaktuar afatet kohore të dorëzimit të raporteve të auditimit, afatet kohore të publikimit të tyre si dhe formatet të standartizuara të raporteve të auditimit.

Referuar nenit 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, KQZ-ja përzgjedhi 17 (shtatëmbëdhjetë) ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e listave shumëëmërore, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Audituesve iu caktua me short se cilat nga 32 parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidatët të propozuar nga zgjedhësit që do të auditonin.

Seksioni IV: Analiza paszgjedhore dhe efektshmëria e teknologjisë së zbatuar

1. Efektshmëria e përdorimit të teknologjisë në zgjedhje

1.1. Implementimi i PEI

- Rekrutimi dhe përzgjedhja e operatorëve teknik.
 - o Koha e shkurtër për përzgjedhjen e stafit dhe mungesa e shprehjes së interesit specifikisht për zona të thella solli në faktin se për 112 QV nuk u arrit gjetja e operatorëve teknik për të operuar PEI gjatë ditës së zgjedhjeve.
- Dorëzimi në kohë i data bazës me listën e zgjedhësve nga DPGJC
 - o Vonesa in ekstremis e marrjes në dorëzim sipas formatit të rënë dakord ndërmjet KQZ –DPGJC rrezikoi mbarëvajtjen e projektit.
- Transmetimi i të dhënave për pjesëmarrjen në ditën e zgjedhjeve
 - o Transmetimi në kohë reale nga PEI nëpërmjet kodit QR të gjeneruar nga PEI dhe skanuar nga aplikimi KQZ nuk rezultoi efektiv për shkak të problemeve teknike.

1.2 Pilotimi i PEVN

Disa nga konkluzionet e pilotimit të pajisjeve PEVN në njësinë Nr. 10, ZAZ 40 janë si më poshtë:

- Ndërfaqja e cila i shfaqet votuesit duhet të jetë sa më e thjeshtë në mënyrë që votuesi të mund ta kryejë procesin e votimit elektronik në një kohë të arsyeshme dhe me lehtësi. Ndërfaqja aktuale e përdorur gjatë pilotimit ishte relativisht e thjeshtë.
- Pajisja PEVN duhet të instalohet nga një person i specializuar dhe i trajnuar për përdorimin e pajisjes PEVN.
- Procesi i nxjerrjes së rezultatit përfundimtar do të ishte shumë më i shpejtë nëse rezultatet printohen në qendrën e votimit që në momentin e mbylljes së procesit të votimit, pa kryer transferimin e të dhënave në server. Transferimi i të dhënave mund të kryhet në një moment të dytë sapo pajisjet të grumbullohen në magazinat e KQZ. Nëse vendoset të votohet

elektronikisht në të gjithë territorin e Shqipërisë atëherë nevojitet që në çdo VNV të ketë dy persona të kualifikuar për importimin e të dhënave nga pajisja PEVN në serverin qendror.

- Procesi i rekrutimit duhet të fillojë minimalisht 6 muaj para datës së votimit.
- Ndërfaqja e votimit duhet të përcaktohet minimalisht 3 muaj para datës së votimit.
- Instalimi i pajisjeve në QV duhet të fillojë dy ditë para datës së votimit.

Seksioni IV: Këqyrja Paszgjedhore

Kërkesat e reja të Kodit Zgjeor kanë ngarkuar KQZ me detyrën e kryerjes së verifikimit paszgjedhor. Sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 7.10.2021 në përfundim të procesit të njohjes dhe marrjes së opinioneve me shoqërinë civile dhe subjektet politike miratoi udhëzimin për procedurat e këqyrjes së materialit zgjedhor.

Në këtë udhëzim u përcaktua procedura e përzgjedhjes rastësore të QV duke specifikuar kufirin maksimal prej 10% të QV për çdo KZAZ.

Me datë 14.10.2021 u përzgjedhën 520 QV të cilat iu nënshtruan procesit të këqyrjes i cili filloi me datë 15.10.2021 dhe është ende në proces.

Procesi i këqyrjes ka si synim verifikimin e parregullsive të administratës zgjedhore duke verifikuar jo vetëm procesin e numërimit, por edhe atë të materialeve zgjedhore nga e cila del më qartë saktësia e veprimeve procedurale të administratës zgjedhore gjatë ditës së zgjedhjeve.

Administrata e KQZ-së bazuar në udhëzimin nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, nga datat 14.10.2021 deri më datë 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore.

Këqyrja u krye në përputhje me kërkesat e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Më datë 14.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përzgjedhi në mënyrë rastësore 519 QV që përfaqësonin 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ nga 5199 QV.

Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 519 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje, të cilët vlerësuan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Ky proces përfundoi më datë 02.11.2021 dhe vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

- Mbledhja e të dhënave

Të dhënat dhe informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes në procesverbalet tip të miratuar me udhëzimin nr. 15/2021 përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore.

Kategoria e parë e informacionit ka të bëjë me saktësinë e shifrave të rezultateve të procesit të vlerësimit të votës për kandidat dhe subjektet zgjedhore. Informacioni është përpunuar në sistem duke indikuar vlerat për çdo kandidat dhe subjekt dhe diferencën për secilin prej tyre në nivel qendre votimi.

Gjatë këtij procesi janë administruar rezultatet e procesverbaleve VPZ-2-NK dhe VPZ-2-NSZ që kanë administruar rezultat e rivlerësimit / rinumërimit për kandidatët e listave shumemërore dhe subjekteve zgjedhore për çdo zonë zgjedhore. Këto procesverbale janë edhe baza e identifikimit të parregullsive.

Kategoria e dytë e informacionit ka të bëjë me plotësimin e një pyetësori shterues dhe shumëdimensional për të vlerësuar performancën dhe përputhshmërinë e zbatimit të detyrave nga ana e komisioneve të nivelit të tretë të administratës zgjedhore.

Nga përpunimi i të dhënave të procesverbalit të verifikimit paszgjedhor model 1 për administrimin zgjedhor (PVZ-1-AZ), janë adresuar 55 pyetje pa përfshirë nënpyetjet që lidhen me pyetjen kryesore.

Pyetjet dhe përgjigjet e tyre janë administruar për të vlerësuar në mënyrë deduktive dhe indikative treguesit e performancës së administratës zgjedhore gjatë ditës së votimit si dhe për të identifikuar proceset që kanë nevojë për t'u përmirësuar më tej.

Identifikimi i problematikave ka përfshirë edhe identifikimin e çështjeve apo situatave që krijuan paqartësi nga zbatimi i Kodi Zgjedhor.

Ky procesverbal shërben si mjeti kryesor për identifikimin e parregullsive përgjatë procesit të administrimit nga administrata zgjedhore.

Më pas të dhënat janë administruar në database dhe janë analizuar në nivel makro duke identifikuar problematikat kryesore dhe vendndodhjen e tyre (KQV konkrete).

Informacioni është kryqëzuar me të dhënat që disponon KQZ (vendimmarrjet e KZAZ për emërimin si anëtarë të KQV / GN) për të identifikuar personat përgjegjës për shkeljet e identifikuar.

- Konstatime dhe problematika

Rregullsia e administrimit zgjedhor nga KQV

Në përgjithësi nga QV-të e këqyrra rezulton se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivelin mesatar 79% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore për të, duke vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjorë dalë në zbatim të tij.

Problematikat e vërejtura më së shumti kanë të bëjnë me konsistencën e zbatimit të kërkesave procedurale për procesin e administrimit të dokumentacionit të punës së KQV-së, në hapje dhe në mbyllje. Vihet re se vendimmarrjet e KQV-ve nuk janë regjistruar paralelisht në procesverbalet tip të miratuar nga KQZ dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Në 8% të QV janë shënuar raste të dorëheqjes / zëvendësimit të anëtarëve të QV. Ky tregues dëshmon për vulnerabilitetet që mund të krijohen përgjatë procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve dhe është një tregues që lidhet edhe me performancën e përgjithshme të komisioneve të qendrave të votimit.

Procesi i dorëzimit të fletëve të votimit nga KZAZ në KQV dhe pasqyrimi i tyre si në procesverbale edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjes nuk ka ndjekur të njëjtin arsyetim / pasqyrim të dhënash bazuar në procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, respektivisht në kërkesat e neneve 101 dhe 113 të Kodit Zgjedhor.

Rezulton që pasqyrimi i të dhënave dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, mbi numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KZAZ-ja është një nga treguesit më të dobët të performancës së administratës zgjedhore të nivelit të tretë. 39% e QV-ve kanë pasqyruar saktë këto të dhëna në LPM.

Sipas udhëzimit 11 / 2021 të Komisionit Rregullator, raporti i hapjes dhe i mbylljes i gjeneruar nga pajisja PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe futet në kuti. Administrimi i raporteve të PEI është bërë në mënyrë jo konsistente nga të gjithë KQV-të dhe konkretisht, janë administruar të nënshkruar dhe të administruar në kuti:

- Në 79 % të QV raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik.
 - Në 81% të QV raporti i mbylljes së procesit të identifikimit elektronik.
- Administrimi i procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve

Vendimet e KQV-ve dhe pasqyrimi i tyre në LPM, procesverbalet për administrimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Nenet 41 dhe 42 të Kodit Zgjedhor përcakton detyrat e Sekretarit të KQV-së dhe vendimmarrjet e komisionit të qendrës së votimit, ndërsa nenet 101 – 114 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat dhe rregullat për procesin e votimit ditën e zgjedhjeve.

Të dhënat e përpunuara tregojnë si më poshtë:

- 85% e QV kanë marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00.
 - o Pjesa tjetër referuar edhe kryqëzimit të informacionit nga pajisjet PEI rezulton të jenë hapur me vonesë deri në orën 08.00.
- 81% e QV kanë marrë vendim për mbylljen e votimit në ora 19:00.
- 82% e vendimeve të QV-ve janë të vulosura me vulën e KQV-së.
- Në 2% të QV-ve janë evidentuar vendimmarrje për pezullim të procedurës së votimit dhe në 1% të rasteve është kërkuar ndërhyrja e policisë në QV.
- Në 3% të QV-ve vëzhguesit kanë paraqitur vërejtje.
- Në 3% të QV-ve kanë filluar procedurën e votimit manualisht dhe më pas kanë kaluar me përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit, ndërsa në 2% të QV-ve është evidentuar kalimi i procedurës manualisht për shkak të problematikave të hasura me PEI.
- Në 14% të QV-ve ka shënime për kohën e largimit dhe të kthimit të anëtarëve nga QV.
- Në 3% të QV-ve ka shënime në LPM të rasteve kur zgjedhësi nuk ka pranuar të kryejë verifikimin elektronik, nuk ka depozituar gjurmët e gishtërinjve për tu identifikuar, apo rastet e tentativave për votim dy herë.
- Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit ndodhet në 94 % të QV-ve.
- Procesverbali i hapjes së qendrës së votimit ndodhet në kutinë e votimit në 80% të QV-ve, ndërsa kopje e tij në kutinë e materialeve të votimit është në 75% të rasteve të këqyrura.
- LPM është tërësisht i paplotësuar në 10 QV.

Administrimi i bazës materiale

Administrimi i bazës materiale zgjedhore (vulat e komisionit të qendrës së votimit dhe vulat me kodet e sigurisë, përdorimi i zarfeve specifike) gjatë ditës së votimit është një tjetër kategori e vlerësimit të performancës së administratës zgjedhore.

- Në 93% të QV-ve të këqyrura, janë dorëzuar vulat me kodet e sigurisë me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë.
- Në 97% të QV-ve të këqyrura numri i kodeve të sigurisë janë të njëjtë me PV (procesverbalin).
- Në 94% të QV-ve të këqyrura fletët e votimit janë sistemuar në zarfe sipas subjekteve zgjedhore.
- Në 65% të QV-ve të këqyrura është administruar dokumenti i printuar nga PEI në zarfin “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”.

Në kutinë e materialeve zgjedhore rezultojnë që janë administruar përgjithësisht dokumentat e mëposhtëm nga ana e KQV-së:

Në mesatarisht 93% të QV-ve baza materiale është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit 11 / 2021 të KQZ-së.

U konstatua se në 21 KQV mungon ky dokument në kutinë e materialeve zgjedhore, veprim që bën me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, i cili protokollon ankesat, kërkesat, dhe njoftimet drejtuar KQV-ve, regjistron në LPM vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara, regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie. Në këto kushte në mbështetje të fakteve të evidentuara nga procesi i këqyrjes rezultoi se Sekretari i QV-së në këto 21 KQV nuk ka përmbushur kërkesën ligjore.

Procesverbalet e hapjes dhe të mbylljes së QV-së, raporti i hapjes dhe i mbylljes PEI

Nga të dhënat e administruara rezultojnë se :

- Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së, vulosur nga sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së si dhe origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit së bashku me raportin e hapjes së procesit të identifikimit elektronik në zarfën ku është shkruar “ZARF I PROCESVERBALIT TË VULOSJES” ndodhet në kuti në 80 % të QV-ve.
- Raporti i mbylljes së procesit të identifikimit elektronik ndodhet në kuti të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së, vulosur nga sekretari i KQV-së me vulën e KQV-së dhe është administruar dokumenti i printuar nga PEI në zarfën ku shënohet “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE” në 81 % të QV-ve.
- Në procesverbalin e mbylljes në 79 % të QV-ve është përcaktuar numri i zgjedhësve që kanë votuar, sipas numrit të zgjedhësve të identifikuar elektronikisht në raportin e mbylljes të printuar nga PEI dhe numrin e zgjedhësve gra të identifikuar.
- Në 86 % të QV-ve përputhet numri i fletëve të votimit të papërdorura të mbyllura në zarfën ku është shënuar “FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA” me të dhënat e pasqyruara në Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në LPM të KQV-s për fletët e votimit të papërdorura.

Në mesatarisht, 82 % të QV-ve janë administruar raportet e identifikimit elektronik të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së e vulosur nga sekretari, janë administruar raportet e hapjes dhe të mbylljes së PEI-t si në kutinë e votimit dhe në kutinë e materialeve zgjedhore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 470/ 2021 miratoi gjetjet e administratës për procesin e këqyrjes paszgjedhore dhe me datë 24.12.2021 i kërkoi KAS vendosjen e sanksioneve administrative për 31 sekretarë të KQV për shkeljet e konstatuara gjatë procesit të këqyrjes. KAS vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 30.000 Lekë për secilin nga 31 (tridhjetënjë) Sekretarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit.

- Verifikimi i saktësisë së numërimit të votave

KQZ në përputhje me përcaktimet e nenit 167 / 2 të Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimit nr. 15 datë 07.10.2021 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, kreu këqyrjen e saktësisë së vlerësimit dhe numërimit të votave.

Grupet e këqyrjes vlerësuan dhe numëruan votat për subjektet dhe për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore. Nga këqyrja paszgjedhore në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore rezultuan se:

- 71 % e QV-ve të këqyrura (371 QV nga 519 QV të këqyrura) rezultuan pa diferencë përgjatë procesit të numërimit.
- 28 % e QV-ve të këqyrura (144 QV nga 519 QV të këqyrura) rezultuan me diferencë nga 1-9 vota.
- 1% e QV-ve (4 nga 519 QV) rezultuan me diferencë nga 10-30 vota si më poshtë:

Nga procesi i këqyrjes paszgjedhore rezultoi se procesi i numërimit të votave për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore rezultuan se:

- 83.6 % e QV-ve kanë diferencë nga 1-9 vota (434 QV nga 519 të këqyrura)
- 7.7 % e QV-ve kanë diferencë nga 10-20 vota (40 QV nga 519 të këqyrura)
- 3.7 % e QV-ve kanë diferencë 21 - 80 vota (17 QV nga 519 të këqyrura)
- 5 % e QV-ve nuk kanë diferencë (26 QV nga 519 të këqyrura).

Për shkak të numrit të subjekteve zgjedhore, numërimit të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore është vlerësuar se marzhi i gabimit nga grupet e numërimit të votave për subjektet nuk ka ndikuar në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve. Ndërkohë ndryshimi i rezultateve nga 1-20 vota për kandidatët është vlerësuar se është një marzh i pranueshëm gabimi njerëzor, referuar edhe standardeve teknike për sa kohë që këto diferencë nuk kanë ndikuar në ndryshim domethënës të rezultatit për kandidatë.

- Votat e pavlefshme dhe natyra e pavlefshmërisë


Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme rezultoi se votat e pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

- 41 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit.
- 25 % e votave të pavlefshme për shkak se është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër.
- 15 % e votave të pavlefshme për shkak se janë me shënime që pamundësojnë vlerësimin e votës dhe favor/disfavor të subjekteve.
- 19 % e votave të pavlefshme janë për arsye të tjera sipas parashikimeve të nenit 117, pika 3 e Kodit Zgjedhor.

- fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyre ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ;
- fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi;
- nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
- zgjedhësi ka votuar për një person apo për një subjekt që nuk është në fletën e votimit.

Seksioni V: Masat administrative dhe disiplinore pas verifikimit aposteriori⁴

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të referuara edhe në këtë raport, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në bazë të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka vendosur sanksione në masën 30.000 lek gjobë për 31 sekretarë të KQV-ve të cilët nuk kishin administruar fare apo nuk kishin plotësuar aspak Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Gjithashtu është bërë kallëzim në prokurori për 18 grupe të numërimit të votave të përbërë nga 67 vetë. KAS shfuqizoi gjetjet e raportit të verifikimit paszgjedhor në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë së administratës së grupit të numërimit të votave për një QV.



Seksioni VI: Raporti i auditimit të kryer për raportimin financiar për fushatën zgjedhore⁵

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, morën pjesë 32 (tridhjetë e dy) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidat të propozuar nga zgjedhësit.

Nga shqyrtimi i raporteve dhe nga krahasimi i të dhënave ndërmjet raporteve të auditimit me raportet financiare të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka konstatuar se:

⁴ Rekomandimi nr. 2 i Rezolutës së Kuvendit

⁵ Rekomandimi nr. 5 i Rezolutes se kuvendit

- Për 18 (tetëmbëdhjetë) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidat të propozuar nga zgjedhësit, nuk ka shkelje të rregullave dhe ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, si dhe në vendimin nr. 13, datë 06.04.2021, të Komisionit Rregullator;
- Për 14 (katërmëdhjetë) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidat të propozuar nga zgjedhësit, edhe pse raportet financiare janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara, janë dorëzuar në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara;
 - 1 (një) subjekt zgjedhor nuk ka respektuar kufirin e lejuar të shpenzimeve, e ka tejkaluar 3-fishin e vlerës së lejuar, të përcaktuar në nenin 92/2, pika 4 të Kodit Zgjedhor.
 - 3 (tre) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje kanë shpenzuar më pak se fondi i shpërndarë nga KQZ dhe referuar nenit 88, pika 7 e KZ duhet të kthejnë diferencën e vlerës së pashpenzuar në KQZ.
 - 1 (një) parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje nuk është audituar, për mungesë komunikimi nga ana e subjektit me ekspertin kontabël të licensuar.

Për sa më sipër struktura përkatëse në KQZ për kontrollin financiar të partive politike, po përgatit projektvendimin në lidhje financimin e partive për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021.

Ndaj vendimit të KAS deri më sot janë ankimuar 4 parti politike në gjykatën administrative për gjetjet e mësipërme.

Seksioni VII: Procese te tjera

1. Procesi i dekriminalizimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të Kreut II, pika 9, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ju informon si më poshtë vijon:

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, u zbatua në të gjitha vendimmarrjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021. Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve, duke ndaluar kandidimin për t’u zgjedhur në funksione publike të deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilat kanë kryer veprime ose mosveprime që përbëjnë vepër penale, sipas disa dispozitave të cituara në mënyrë shteruese në këtë ligj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar 1841 (njëmijë e tetëqind e dyzet e një) kandidatë për deputet, 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) kandidatë për anëtarë këshilli bashkiak, 2 (dy) deputetë, 2 (dy) anëtarë të Këshillit të Ministrave.

Plotësimi i vakancave të krijuara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për vitin 2021

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë 2 (dy) vendime për dhënie mandati dhe 1 (një) vendim për moszgjedhshmëri për arsye të mosdepozitimit të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit, lidhur me vakancat e njoftuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve, mandate të fituara në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017, si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 367, datë 25.05.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, zj. Gentiana Xhemal Cakrani”;
- Vendim nr. 369, datë 27.05.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, qarku Shkodër, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta”;
- Vendim nr. 368, datë 25.05.2021 “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, z. Gledis Esat Çeliku, për plotësimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë 4 (katër) vendime për dhënie mandati, lidhur me vakancat e njoftuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve, mandate të fituara në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021, si vijon:

- Vendim nr. 440, datë 10.09.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, zj. Mimi Pjetër Kodheli”;
- Vendim nr. 441, datë 10.09.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Durrës, z. Denis Mehmet Deliu”;
- Vendim nr. 442, datë 10.09.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, zj. Mirela Llambro Pitushi”;
- Vendim nr. 443, datë 10.09.2021 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit PD-AN, qarku Lezhë, zj. Elda Artan Hoti”.

Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për kandidatët për deputet për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

Janë kryer verifikime për 1841 (njëmijë e tetëqind e dyzet e një) kandidatë për deputet, si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, nga të cilët 732 (shtatëqind e tridhjetë e dy) gra dhe 1109 (njëmijë e njëqind e nëntë) burra.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda afatit të parashikuar në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike” dhe

vendimin nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, fillimisht verifikoi prima facie nëse ndonjë nga rrethanat përfshihej në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, si dhe kërkoi informacion për kandidatët për deputet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të tyre.

Nga verifikimet rezultoi se:

- 64 (gjashtëdhjetë e katër) kandidatë kishin deklaruar dënime/masa/dëbime;
- 1777 (një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) kandidatë nuk kishin deklaruar asnjë dënim;
- 1 (një) kandidat rezultoi me masë në fuqi;

Z. Ido Muharrem Pashaj, kandidat për deputet i Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët, qarku Fier, ka deklaruar në FVD që ndaj tij është caktuar masë shtrënguese e sigurisë, ndalim i daljes jashtë shtetit për arsye dokumentacioni, masë e cila është aktualisht në fuqi, u konstatua që në momentin e verifikimit prima facie.

- 23 (njëzet e tre) kandidatë kanë qenë të dënuar/dëbuar jashtë vendit për të cilët Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme, si vijon:

1. Arbër Arifaj, LSI, dëbuar mungesë dokumentacioni
2. Altin Gjeloshaj, ABEOK, dëbuar
3. Elsa Voka, ABEOK, dëbuar mungesë dokumentacioni
4. Gentjan Muça, PD, dëbuar shkelje e vizës studentore
5. Rezeart Tusha, PD, dëbuar tejkalim i lejes së qëndrimit
6. Kleo Murataj, PSD, ndaluar/arrestuar në Hannover
7. Agron Kapllanaj, PD, dënuar në Itali, vepra e parashikuar nga 624 c.p
8. Halim Dauti, PS, dëbuar emigracion
9. Ashim Tafilaku, LSI, dëbuar mungesë dokumentacioni
10. Ilir Hysi, LSI, arrest me burg në Itali
11. Ferdinand Aligjoni, LSI, arrest me burg në Itali për përdorim të të dhënave nga të tretët
12. Leonard Beqiri, PS, i dyshuar për përdorim të dhënash fallco, Aachen, Gjermani
13. Elton Ismaili, LSI, arrestuar dhe dëbuar në Greqi, arsye dokumentacioni
14. Artan Bitri, PS, dëbuar mungesë dokumentacioni
15. Ido Pashaj, ABEOK, dënuar në Itali për rrahje dhe dëbuar
16. Ervis Beu, ABEOK, dënuar dhe dëbuar për kalim të paligjshëm në Itali
17. Daniel Prroj, kandidat i regjistruar në listat e para të ABEOK, por që nuk është miratuar në listat përfundimtare, dëbuar
18. Boris Shakaj, NTH, dëbuar Gjermani refuzim azili
19. Ilmi Kuka, LRE, dëbuar Greqi mungesë dokumentacioni

20. Dashamir Tahiri, LN, dënuar në Itali për falsifikim leje drejtimi
21. Bahri Shabani, BD, arrest me burg në Gjermani, emigracion i paligjshëm
22. Arsen Belaj, BD, ndaluar mungesë dokumentacioni Itali
23. Boiken Abazi, kandidat i pavarur, ndaluar për verifikim dhe ndalim i hyrjes në Rep. e Kosovës për 2 vjet

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar verifikim të thelluar për 30 (tridhjetë) kandidatë për deputetë, për shkak të deklaramit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti të huaj siç është pasqyruar më lart (23 kandidatë), apo indicieve të bëra prezente për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vepra të tjera të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara si ndalime në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit ka përcjellë pranë KQZ-së 11 (njëmbëdhjetë) vendime “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, nga të cilat 10 (dhjetë) vendime janë shqyrtuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ndërsa për 1 subjekt është në proces vlerësimi. Nga verifikimi i formularëve rezulton se:

- 42 (dyzet e dy) kandidatë nuk kanë deklaruar dënime/masa/dëbime, por rezultojnë të dënuar sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nga të cilët 11 (njëmbëdhjetë) i përkasin partive që kanë marrë mandat në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe 31 (tridhjetë e një) i përkasin partive të cilat nuk kanë fituar asnjë mandat, të paraqitura si më poshtë vijon:
 - LSI 4 (katër) kandidatë, në qarkun Vlorë, Berat, Elbasan dhe Shkodër,
 - PD-AN 2 (dy) kandidatë, në qarkun Shkodër dhe Tiranë,
 - PSD 5 (pesë) kandidatë në qarkun Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan dhe Tiranë,
 - NTH 2 (dy) kandidatë, në qarkun Dibër dhe Tiranë,
 - ADR 1 (një) kandidat në qarkun Elbasan,
 - PBK, 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë, në qarkun Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Tiranë dhe Vlorë.
 - ABEOK 9 (nëntë) kandidatë, të ndara sipas partive në vijim: Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar 2 (dy) kandidatë, në qarkun Tiranë dhe Shkodër;
 - Partia Kombëtare Konservatore Albania 6 (gjashtë) kandidatë, në qarkun Lezhë, Shkodër, Berat dhe Tiranë dhe Partia Ora e Shqipërisë 1 (një) kandidat, në qarkun Korçë,
 - PLDSH 2 (dy) kandidatë, në qarkun Fier dhe Vlorë,
 - LRE 2 (dy) kandidatë, në qarkun Lezhë dhe Vlorë.
 - 185 (njëqind e tetëdhjetë e pesë) kandidatë kanë deklaruar ndryshime në gjenealitete;
2. Shqyrtimi i rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021, për kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (2021-2025), për anëtarë në këshillin bashkiak (2019-2023) dhe për kryetar bashkie (2019-2023)

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2021, nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit janë dërguar 14 (katërbëdhjetë) vendime për përfundimin e verifikimit të thelluar, nga të cilat 11 (njëmbëdhjetë) vendime për kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë 2021-2025, 2 (dy) vendime për anëtarë në këshillin bashkiak 2019-2023 dhe 1 (një) vendim për Kryetar Bashkie 2019-2023.

Në lidhje me këto vendime të Prokurorisë së Përgjithshme pas verifikimit të thelluar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur si vijon:

- a. deklarimin e përfundimit të procedurës administrative pa vendim përfundimtar për:
 - 6 (gjashtë) kandidatë për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar, për sa kohë, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, këto subjektet nuk do të mund të përfitojnë mandatin e deputetit për legjislaturën 2021 - 2025;
 - 2 (dy) anëtarë në këshillin bashkiak, për shkak se subjektet kanë dhënë dorëheqjen, nga funksioni i tyre si këshilltarë në këshillat bashkiakë dhe për rrjedhojë nuk janë subjekte të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- b. 4 (katër) kandidatë për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nuk përfshihen në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015.
- c. 1 (një) Kryetar Bashkie, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Për 1 (një) kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë 2021-2025, KQZ është në proces vlerësimi.

Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtar në këshillat bashkiakë, gjatë procesit të plotësimit të vakancave të krijuara për vitin 2021

Për vitin 2021 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- a. Janë dorëzuar 68 (gjashtëdhjetë e tetë) formularë vetëdeklarimi nga kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, pas njoftimit nga këshilli i bashkisë për vakancën e krijuar në këtë institucion, (2 (dy) kandidatë kanë dhënë dorëheqjen).
- b. Për vitin 2020 janë dorëzuar 3 (tre) formularë vetëdeklarimi nga kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, pas njoftimit nga këshilli i bashkisë për vakancën e krijuar në këtë institucion, për të cilat procedura e vendimmarrjes nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka përfunduar gjatë vitit 2021,
- c. Për vitin 2022 janë dorëzuar 3 (tre) formularë vetëdeklarimi nga kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, pas njoftimit nga këshilli i bashkisë për vakancën e krijuar në këtë

institucion, vakancë e mbartur nga viti 2021, për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është shprehur me vendimmarrje përtej periudhës së raportimit, përgjatë vitit 2022.

Gjithsej kemi 72 (shtatëdhjetë e dy) formularë vetëdeklarimi të depozituara në KQZ nga kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak.

Vendimmarrja nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nga verifikimi prima facie i formularëve të vetëdeklarimit për 72 (shtatëdhjetë e dy) kandidatë për anëtar në këshillin bashkiak, rezultoi se:

- a. 1 (një) prej kandidatëve për anëtar në këshillin bashkiak, ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit masë sigurimi personal “Arrest me burg”, të revokuar, i cili është dërguar për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme.
- b. 21 (njëzet e një) kandidatë për anëtarë në këshillat bashkiak, kanë deklaruar/rezultuar në formularin e vetëdeklarimit ndryshime në gjenealitete;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar, mbështetur në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, dhe Vendimin e Kuvendit nr.17/2016 kërkoi informacion për të gjithë kandidatët për anëtar në këshillin bashkiak, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për gjendjen gjyqësore të tyre.

Pas verifikimit, përgjatë vitit 2021 procedura e vendimmarrjes nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka përfunduar për 65 (gjashtëdhjetë e pesë) kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiak nga të cilat:

- 62 (gjashtëdhjetë e dy) vendime janë për kandidatët që kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në vitin 2021,
- 3 (tre) vendime janë për kandidatët që kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në vitin 2020.

Ndërsa për 7 (shtatë) kandidatë për anëtar të cilët kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit, procedura e vendimmarrjes nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka vijuar përtej periudhës së raportimit, përgjatë vitit 2022;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që këta kandidatë për anëtar në këshillat bashkiakë nuk ishin në kushtet e moszgjedhshmërisë, si dhe vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit. Respektivisht kandidatët për anëtar të zëvendësuar me vendimet përkatëse të KQZ-së përgjatë vitit 2021 janë 36 (tridhjetë e gjashtë) gra dhe 29 (njëzet e nëntë) burra.

Nuk kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit 33 (tridhjetë e tre) kandidatë për anëtar në këshillat bashkiakë, pas njoftimit me shkresë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çka vlerësohet si refuzim në kuptim të ligjit.

Nga vakancat e ardhura kemi 24 (njëzet e katër) raste papajtueshmërie me funksionin e anëtarit të këshillit bashkiak, nga të cilat 11 (njëmbëdhjetë) gra dhe 13 (trembëdhjetë) burra.

Janë tërhequr nga marrja e mandatit me kërkesë të tyre, disa me deklaratë noteriale, me dorëheqje drejtuar këshillit bashkiak ose KQZ, 19 (nëntëmbëdhjetë) kandidatë nga të cilët 16 (gjashtëmbëdhjetë) gra dhe 3 (tre) burra.

Nga plotësimi i vakancave të krijuara në këshillat bashkiak gjatë vitit 2021, aktualisht kanë shteruar listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në këto bashki:

- a. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Partisë Socialiste të Shqipërisë në Bashkinë Kuçovë, Belsh, Lushnjë, Roskovec, Kavajë dhe Vlorë.
- b. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar të Partisë së Gjelbër në Bashkinë Belsh.

2. Financimi vjetor i partive politike

Shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike.

Në zbatim të nenit 15/2, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8580, “Për partitë politike”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimin nr. 24, datë 02.02.2021, “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore, për vitin 2021”. Vendimi përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Ligji nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, ka parashikuar fondin prej 140 milionë lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2021. Shpërndarja e fondeve vjetore u bë si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi i Partisë Politike	Fondi i përfituar/Lekë
1	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	63.417.047
2	Partia Demokratike (PD)	38.911.877
3	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	7.447.477
4	Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	20.012.797
5	Partia Social Demokrate (PSD)	5.369.137
6	Partia Lista e Barabartë (LIBRA)	4.841.667

	TOTALI	140.000.000
--	--------	-------------

Seksioni VIII: Raporti i auditimit të kryer për raportimin financiar për vitin kalendarik⁶

Pas dorëzimit të raporteve financiare vjetore për vitin kalendarik 2020 nga partitë politike që rezultojnë të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, referuar ligjit për Partitë Politike, KQZ përzgjedhi me short 17 ekspertë kontabël të licensuar për të kryer auditimin e 131 (njëqind e tridhjetë e një) Partive Politike. Me vendim nr. 430 datë 22.07.2021, I Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve, “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020, si edhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”, vendosi masa administrative, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike, që nuk kanë dorëzuar raportin vjetor financiar për vitin kalendarik 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për 4 (katër) partitë politike që e kanë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi i Komisionerit u ankimua në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) nga ana e 20 (njëzetë) partive politike të përmbledhura në 12 (dymbëdhjetë) kërkesa ankimore. Në përfundim të shqyrtimit administrativ KAS vendosi: Ndryshimin e vendimit nr. 430, datë 22.07.2021, “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 si dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pranimin e kërkesës ankimore, heqjen e sanksionit administrativ për 2 parti politike.

Pranimin pjesërisht të kërkesave ankimore të 3 (tre) partive politike dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Rrëzimin e kërkesës për 2 (dy) parti politike dhe lënien në fuqi të sanksionit administrativ në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 430, datë 22.07.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për 13 (trembëdhjetë) parti politike dhe vendosjen e sanksionit administrativ në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Fushata e Edukimit Zgjedhor 2021 në format elektronik sipas kodit për skanim

⁶ Rekomandimi 5 i Rezolutes se kuvendit



KQZ



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



www.kqz.gov.al